



Botues: Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger
Përkthyes: "UEGEN"
Përgjegjës për botimin shqip: Astrit Dautaj

Pjesëmarrja në demokraci

Veprimtari mësimore për Qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut
Për shkollën e mesme

PJESËMARRJA NË DEMOKRACI

Veprimtari mësimore për Qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut, për shkollën e mesme

Redaktuar nga Rolf Gollob, Peter Krapf dhe Wiltrud Weidinger

Autor: Peter Krapf

Illustrimet nga Peti Wiskemann

Përgjegjës për përkthimin nga anglishtja: Astrit Dautaj

Vëllimi IV

i

Vëllimeve I-VI të EQD / EDNJ

Edukimi për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në praktikën shkollore

Veprimtari mësimore, koncepte, metoda dhe modele

Botim i Këshillit të Evropës

Opinionet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet në çfarëdo forme, me mjete elektronike (CD-Rom, Internet, etj) ose mekanike, përfshirë fotokopjimin, incizimin apo ruajtjen e informacionit e rikthimin e tij me anë të ndonjë sistemi, pa lejen paraprake me shkrim nga Divizioni i Publikimeve dhe Informimit Publik, Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Koordinimi për prodhimin, faqosjen dhe redaktimin e këtij vëllimi është kryer nga IPE (Projekte Ndërkombëtare në Edukim; www.phzh.ch/ipe) të Universitetit të Zyrihut për Edukimin e Mësuesve (Pädagogische Hochschule Zürich).

Ky publikim është bashkë-financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

pädagogische Hochschule Zürich

Projektet ndërkombëtare në Arsim
www.phzh.ch/ipe



Schweizerische Eidgenossenschaft
Konfederata zviceran Confederazione
Svizzera Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim SDC**

Ilustrimet: Peti Wiskemann
Kopertina: Njësia e Botimeve Desktop, Këshilli i Evropës
Faqosja: Jouve, Paris

Botime të Këshillit të Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
<http://book.coe.int>

ISBN 978-92-871-6833-7
© Këshilli i Evropës, Shtator 2010
Shtypur në Belgjikë

Bashkëpunuan:

Emir Adzovic - Bosnja dhe Hercegovina
Manuela Droll - Gjermani
Christian Fallegger - Zvicër
Rolf Gollob - Zvicër
Sarah Keating-Chetwynd - Këshilli i Evropës
Sabrina Marruncheddu Krause - Zvicër
Olof Olafsdottir - Këshilli i Evropës
Karen O'Shea - Republika e Irlandës
Wim Taelman - Belgjikë
Wiltrud Weidinger - Zvicër

Përmbajtja

Hyrje	
1. Çfarë na mundëson ky manual? - Një përmbledhje e shkurtër	7
2 Çfarë është EQD / EDNJ? - Tre dimensionet e EQD / EDNJ	7
2.1 Dimensioni njohës i EQD / EDNJ: të mësuarit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut	8
2.2 Dimensioni pjesëmarrës i EQD / EDNJ: të mësuarit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut	9
2.3 Dimensioni kulturor i EQD / EDNJ: të mësuarit përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut	10
3. Korniza konceptuale e këtij manuali - tre "C" në EQD / EDNJ (Sfidat, Konstruktivizmi, Kompetencat)	11
4. "Qasja evropiane" ndaj EQD / EDNJ	12
Të mësuarit ndërveprues konstruktivist në EQD / EDNJ	15
1. Pyetjet kyçe për didaktikës në EQD / EDNJ	16
2. Një shembull i të mësuarit konstruktivist interaktiv - nxënësit e rinj përfytyrojnë botën e tyre ideale	17
3. Çdo person mëson ndryshe - "Ne e krijojmë botën në mendjet tona"	19
4. Të mësuarit konstruktivist dhe ndërveprimi shoqëror	21
5. Cili është roli i mësuesit në proceset e të mësuarit konstruktivist?	22
6. Cili është roli i mësuesit në EQD / EDNJ?	23
6.1 Mësuesi si lektor dhe instruktor - për të mbështetur dhe pasuruar konstruksionin	23
6.2 Mësuesi si kritik dhe korrektor - për të mbështetur analizën	24
6.3 Mësuesi si krijues dhe ofrues i detyrave të aplikimit - për të mbështetur rindërtimin	24
6.4 Mësuesi si kryesues në seanca plenare - për të mbështetur të gjitha format e të mësuarit konstruktivist	25
7. Demokracitë si komunitete të nxënësve - një qasje konstruktiviste për konceptet kyç në EQD / EDNJ	27
Pjesa 1 - Pjesëmarrja në komunitet	
Kapitulli 1: Identiteti. Të zgjedhim. Ne formojmë jetën tonë,por edhe të të tjerëve	30
Kapitulli 2: Përgjegjësia. Pjesëmarrja, marrja e përgjegjësive. Liria mbart përgjegjësi	56
Kapitulli 3: Diversiteti dhe pluralizmi. Aprovimi përmes mospajtimit? Si mund të biem dakord për të mirën e përbashkët?	75

Pjesa 2 - Pjesëmarrja në politikë: zgjidhja e konfliktit, zgjidhja e problemeve	
Kapitulli 4: Konflikti. Konflikti i peshkimit. Si mund të zgjidhim dilemën e qëndrueshmërisë?	100
Kapitulli 5: Rregullat dhe ligji. Cilat rregulla na shërbejnë më mirë? Një lojë vendimmarrjeje	125
Kapitulli 6: Qeverisja dhe politika. Modeli i ciklit politik. Si i zgjidh një komunitet demokratik problemet e tij?	141
Kapitulli 7: Barazia. Rregulli i shumicës - një rregull i drejtë? Si mund të	

zgjidhim çështjen shumicë/minoritët në demokraci?	163
Pjesa 3 - Pjesëmarrja në politikë: Pjesëmarrja nëpërmjet komunikimit	
Kapitulli 8: Liria. Debati në publik. Pse liria (e fjalës) nuk funksionon pa rregulla të ngurta? ...	178
Kapitulli 9: Media. Pjesëmarrja në demokraci nëpërmjet medieve. Prodhuesit dhe përdoruesit e medias si mbikëqyrës dhe përcaktues të rendit të ditës	195
Manual për nxënësit, me fletë pune	213

Hyrje

1. Çfarë na mundëson ky manual? - Përmbledhje e shkurtër

Ky manual përmban nëntë kapitull mësimore për Edukimin për Qytetari Demokratike (EQD) dhe të Drejtat e Njeriut (EDNJ). Sikundër na tregojnë edhe titulli, pjesëmarrja në demokraci dhe fotoja e kapakut, kapitujt në këtë manual u drejtohen nxënësve në rolin e tyre si qytetarë të rinj. Çdo kapitull mundëson një qasje të veçantë për të fuqizuar dhe inkurajuar nxënësit për pjesëmarrje në komunitetet e tyre.

Çdo kapitull mund të përdoret më vete ose e kombinuar me kapitujt e tjerë në mënyra të ndryshme. I gjithë manuali përfshin një program për trajnimin e kompetencave për pjesëmarrje në demokraci.

Kapitujt, të përbërë nga katër mësim secili, janë të destinuara për nxënësit e shkollës së mesme (klasat 10-12). Çdo kapitull përqendrohet në një koncept kyç që lidhet me EQD dhe EDNJ: identiteti – përgjegjësia – diversiteti dhe pluralizmi - konflikti - rregullat dhe ligji - qeveria dhe politika - barazia – liria dhe media. Ky grup konceptesh kyçe e lidh këtë manual me vëllimet shoqëruese për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (EQD / EDNJ, Vëllimi II dhe III).¹ Së bashku, të tre vëllimet na japin një program spiral të koncepteve kyç në EQD dhe EDNJ.

Çdo kapitull përqendrohet në një koncept kyç dhe përbëhet nga katër mësim. Në çdo mësim, përshkruhen me hollësi hapat e sugjeruara të mësimdhënies, aq sa kjo është parë e arsyeshme. Fletët e punës janë ofruar në një pjesë të veçantë për nxënësit.

Ky libër u kushtohet mësimdhënësve, jo nxënësve. Ne shpresojmë që të trajnuarit dhe ato që janë të rinj e të reja në profesionin e mësimdhënies do të vlerësojmë planet e hollësishme të mësimit, por edhe mësuesit me përvojë mund të gjejnë ide dhe materiale për t'i integruar në orët e tyre të mësimit. Trajnuesit mund ta përdorin këtë libër si manual për trajnimin e mësuesve të EQD dhe EDNJ.

Ky manual u shërben edhe hartuesve të kurrikulës, redaktorëve të teksteve dhe përkthyesve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ai mund të përkthehet dhe të përshtatet për të përmbushur kërkesat specifike brenda sistemeve të tyre arsimore.

Këshilli i Evropës e paraqet këtë manual në një version të rishikuar. Botimi i parë doli në Bosnje e Hercegovinë për të mbështetur një lëndë të re të futur rishtazi në shkollë, “Demokracia dhe të Drejtat e Njeriut” (2002). Që nga viti 1996, Këshilli i Evropës ka qenë i angazhuar në trajnimin e mësuesve dhe trajnerëve në fushën e EQD dhe EDNJ, duke ofruar trajnime të mësuesve në punë dhe zhvillim të materialeve mësimore. Rolf Gollob dhe Peter Krapf (bashkë-redaktorët), bëjnë pjesë në ekipin ndërkombëtar të trajnerëve që kanë marrë pjesë në këtë projekt.

2. Çfarë është EQD / EDNJ? - Tre dimensionet e EQD / EDNJ

Qëllimet dhe parimet e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut (EQD / EDNJ) janë të lidhura me tre dimensionet e mësimdhënies dhe të mësuarit. Nxënësit në arsimin e mesëm janë qytetarë të rinj, të cilët:

- duhet të dinë të drejtat e tyre të njeriut dhe të kuptojnë kushtet nga të cilat ata varen (të mësuarit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut);
- kanë përjetuar shkollën si një mikro-komunitet që respekton lirinë dhe barazinë e nxënësve të saj, dhe janë trajnuar në ushtrimin e të drejtave të tyre (të mësuarit **përmes** demokracisë dhe të drejtave të njeriut);

¹ EQD/EDNJ Vëllimi II: Rritimi në demokraci – EDC/HRE veprimtari mësimore për arsimin fillor; EDC/HRE Vëllimi III: Jetojmë në demokraci – EDC/HRE veprimtari mësimore për arsimin e mesëm të ulët

- për këtë arsye, janë kompetentë dhe të sigurt në ushtrimin e të drejtave të tyre njerëzore, me pjekuri dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve dhe komunitetit (të mësuarit **për** demokracinë dhe të drejtat e njeriut).

Kjo përmbledhje e shkurtër e EQD / EDNJ mund të shpjegohet më së miri me një shembull - të drejtën e mendimit dhe shprehjes. Hyrja në EQD / EDNJ Vëllimi III (f.5) trajton të njëjtin shembull; në këtë manual, reflektimi për këtë të drejtë të njeriut është çuar disa hapa më tej (të kurrikulës spirale).

2.1 Dimensioi njohës i EQD / EDNJ: të mësuarit rreth demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Në orët e EQD / EDNJ në arsimin e mesëm, nxënësit duhet të studiojnë dokumente kyçe, të tilla si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR) dhe Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, KEDNJ) (shih edhe fletët e punës së nxënësve 2.5 dhe 2.6). Ata duhet të dinë se çdo person gëzon të drejtën e mendimit dhe të shprehjes së lirë dhe garantimin e të drejtës për të marrë lirisht informacione përmes medieve të pa censuruara (KEDNJ, neni 10). Nxënësit duhet të kuptojnë se sa e rëndësishme, madje e domosdoshme, është kjo e drejtë për të bërë demokracinë pjesë të jetës sonë.

Nxënësit duhet gjithashtu të kuptojnë nenin 14 të KEDNJ. Ai i shton lirisë së mendimit, të shprehjes dhe të informimit parimin kyç të barazisë dhe mosdiskriminimit: burra dhe gra, të pasur dhe të varfër, të rinj dhe të vjetër, shtetas dhe emigrantë - të gjithë i gëzojnë këto të drejta në mënyrë të barabartë.

Në fund, nxënësit duhet të kuptojnë se përse liritë kërkojnë një kuadër ligjor. Ata duhet të kuptojnë edhe përgjegjësitë që bartin liritë. (DUDNJ, neni 29). Liria e shprehjes lejon qytetarët për të promovuar interesat e tyre në një shoqëri pluraliste dhe, në një mjedis të tillë konkurrues, do të ketë fitues dhe humbës. Një kushtetutë, rregullat dhe ligjet duhet të sigurojnë një kornizë që kufizon liritë e të fortëve dhe mbron të dobët - pa i sheshuar dallimet. Rregullat nuk mund të kujdesen për çdo problem. U takon anëtarëve të një komuniteti të ndajnë përgjegjëshmërisë e tyre ndaj njëri-tjetrit.

KONVENTA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (4.11.1950)

NENI 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

NENI 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe, të tilla, si: seks, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (10.12.1948)


Neni 29.

1. Gjithkush ka detyrime vetëm ndaj atij komuniteti në të cilin është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të njohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të plotësimit të kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

Me pak fjalë, këta tre nene përshkruajë tensionin mes lirive individuale dhe inkuadrimin të lirisë nëpërmjet një rendi publik që edhe t'i kufizon edhe t'i mbron këto liri.

Nxënësit të cilët mund të shpjegojnë këtë kanë mësuar mjaft **rreth** demokracisë dhe të drejtave të njeriut, dhe lexuesi do të shohë se kjo temë kyç kalon përmes të gjitha njësive të këtij manuali. Ky është dimensionin njohës i EQD / EDNJ.



Diagramë: "Arkitectura" e të drejtave të njeriut - lajtmotivi i këtij manuali

2.2 Dimensionin pjesëmarrës i EQD / EDNJ: të mësuarit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut

Titulli i këtij manuali, *Pjesëmarrja në demokraci*, na kujton që nxënësit duhet të mësojnë se si të ushtrojnë të drejtat e tyre për liri, për shembull, të drejtën për të zotëruar lirisht informacionet, dhe të mendimit, opinionit dhe të shprehjes së lirë. Ata duhet të kenë përvojë aktive në bashkëveprimin me të tjerët - për shembull, për promovimin e interesave të tyre, për të negociuar për kompromis ose të rënë dakord se si të përcaktojnë "mirëqenien e përgjithshme" (DUDNJ, neni 29). Ata duhet të jenë në gjendje të veprojnë brenda një kuadri të rregullave dhe të pranojnë kufizimet që mund të imponohen për ta. Ata duhet të kenë të zhvilluar një qëndrim të përgjegjës për mirëqenien e të tjerëve dhe të komunitetit në tërësi.

Me pak fjalë, ata duhet jo vetëm të kenë kuptuar implikimet dhe lidhjet në mes të tri neneve të të drejtave të njeriut që trajtohen më lartë, por kanë mësuar edhe të vlerësojnë vlerat e tyre themelore dhe të veprojnë në përputhje me to. Duke bërë këtë, ata duhet të jenë në gjendje të harmonizojnë interesat e tyre me ato të të tjerëve dhe të komunitetit të tyre, si një i tërë.

Nxënësit që janë trajnuar në këtë mënyrë kanë mësuar se si të marrin pjesë në demokraci. Ky është dimensionin me bazë veprimin në EQD / EDNJ - të mësuarit për demokracinë dhe të drejtat e njeriut.

Qytetarët e rinj të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në demokraci kanë nevojë për një grup kompetencash shumëdimensionale që janë treguar në modelin më poshtë.

Kompetencat e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes politike	
Kompetencat e analizës dhe gjyqimit	Metodat dhe aftësitë

Këto kompetenca duhet të jenë të orientuara drejt vlerave; në duart e racistëve, ato do të ktheheshin në një kërcënim për komunitetin demokratik.

Ky manual fokusohet në zhvillimin e kompetencave të tilla. Hyrja, për çdo kapitull, përfshin një matricë që lejon përdoruesit për të kombinuar kapitujt që të hartojnë kurrikulën e trajnimit të kompetencës, në varësi, për shembull, të nevojave të mësuarit të nxënësve të tyre ose të kërkesave specifike të programit të tyre mësimor. Këtu është tabela e kompetencave për njësinë 2 (koncepti

Kapitujt	Dimensionet e zhvillimit të kompetencave			Qëndrimet dhe vlerat
	Analiza dhe gjykimi politik	Metodat dhe aftësitë	Vendimmarrja politike bëhet veprim	
2. Përgjegjësia	Kuptimi i çështjeve të dilemës Analiza e pasojave të një vendimi Përcaktimi i prioriteteve dhe dhënia i arsyeve	Shqyrtim dhe mendim i kujdesshëm Ndarja e arsyetimeve dhe kritereve për një vendim	Vendimmarrja e bazuar në informacione jo të plota Ndërgjegjësimi për rrezikun e dështimit	Ndryshimi i këndvështrimeve
1. Identiteti	Kuptimi i ndikimit të zgjedhjeve tona për të tjerët			
4 Konflikti	Dilema e vazhdimësisë		Zgjidhje konflikti	Ndryshimi i këndvështrimeve
6 Qeverisja dhe politika	Politika - një proces i zgjidhjes së problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve	Strategjitë e negociimit		
7 Barazia	Vlerësimi i dimensionit kulturor të demokracisë		Balancimi i të drejtave të shumicës dhe pakicës	Njohja reciproke

2.3 Dimensioi kulturor i EQD / EDNJ: të mësuarit përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut

Pjesëmarrja në demokraci është një biznes i kërkuar - kompetencat mund dhe duhet të mësohen e të zhvillohen në shkollë. Prandaj, EQD / EDNJ ka një dimension kulturor. Kultura e mësimdhënies dhe të mësuarit duhet të reflektojnë mesazhin e EQD / EDNJ. Një mënyrë e marrjes së njohurive është përmes udhëzimit (dëgjuar një leksion, duke lexuar); kompetencat janë zhvilluar përmes trajnimit (demonstrimit, praktikës dhe stërvitjes). Vetëbesimi dhe vlerat e respektit të ndërsjellë janë fituar përmes një procesi shoqërizimi në shkollë. Përvoja në klasë dhe modelet e roleve të vendosura nga prindërit, mësuesit dhe shokët e klasës ndikojnë në zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerave të një personi të ri. Ndërsa mësim **rreth** demokracisë dhe të drejtave të njeriut është një detyrë e caktuar për lëndë të veçanta (p.sh. studimet sociale, historia, edukimi qytetar), të mësuarit **përmes** demokracisë dhe të drejtave të njeriut është një sfidë për të gjithë shkollën - të drejtat e njeriut dhe demokracia shndërrohen në udhëzues për të gjithë komunitetin pedagogjik të shkollës.

Ky manual përdor qasjen e të mësuarit në bazë të detyrave: çdo kapitull përmban një detyrë të rëndësishme që i jep nxënësve mundësinë për të zhvilluar një kompetencë specifike. Ne i zhvillojmë kompetencat sipas nevojave, dhe për këtë arsye këto detyra trajtojnë probleme për të cilat nuk ekzistojnë zgjidhje të qarta e të prera - siç është rasti në jetën reale. Në EQD / EDNJ, metoda mbart një pjesë të rëndësishme të mesazhit.

3. Korniza konceptuale e këtij manuali- Sfida, Konstruktivizëm, Kompetenca

Qytetarët e rinj që marrin pjesë në demokraci e bëjnë këtë si individë të lirë me të drejta të barabarta, por me shanse të pabarabarta.

Si anëtarë të shoqërive dinamike pluraliste që janë globalisht të ndërvarura, ata përballen me **sfida** gjithnjë e më komplekse (p.sh. ndryshimet klimatike, shterimi i burimeve natyrore, shtete që dështojnë), për të cilat shkolla nuk mund të ofrojë ndonjë zgjidhje konkrete, por mund të ofrojë **trajnime kompetencash** për të pajisur brezin e ri me mjete me të cilat mund të zhvillojë zgjidhje.

Përballimi i këtyre sfidave është një çështje e provës, gabimeve dhe negociemeve të kompromiseve midis interesave të ndryshme. Rezultati i proceseve të tilla vendimmarrëse mund të kuptohet si një përpjekje për të arritur qëllimin e të mirës së përbashkët. Rezultati është gjithmonë i paplotë, dhe i hapur menjëherë për diskutim kritik dhe përmirësim. Prandaj, një demokraci pluraliste zgjedh qasjen **konstruktiviste** për hartimin e politikave. Demokracia është, kështu, një shtet i pasigurt që varet nga kompetencat dhe përgjegjësia e çdo brezi. **Konstruktivizmi** është parimi që mbështet zhvillimin e kompetencave - përsëri një proces i pafund.

Këto janë tri konceptet kryesore që përçojnë çdo kapitull dhe çdo hap të mësuarit të këtij manuali:

- **Sfidat** në komunitetet dinamike pluraliste demokratike;
- **Kompetencat** e pjesëmarrjes në demokraci;
- **Konstruktivizmi** si një paradigmë e vendimmarrjes demokratike dhe e zhvillimit të kompetencave.

Brenda çdo kapitulli, një koncept kyç i EQD / EDNJ lidhet me sfidat specifike që krijojnë mundësi mësimi për zhvillimin e kompetencave konstruktiviste. Kjo është arsyeja përse, konceptet nuk japin nëntë module të izoluara të të mësuarit njohës. Përkundrazi, ato krijojnë një rrjet të shkathtësive, vlerave dhe këndvështrimeve që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në shumë mënyra. Matrica e mëposhtme përshkruan kornizën konceptuale të manualit.

	Lexim konstruktivist ...	
Kapitulli/Koncepti kyç	...i koncepteve kyç si sfida	...i zhvillimit të kompetencës si një proces gjatë gjithë jetës. Nxënësit janë të trajnuar
Kapitulli 1 Identiteti	Çfarë pune duhet të zgjedh unë? Kush do të jetë partneri im? A duam të kemi fëmijë?	për të reflektuar për, për të shprehur dhe për të përcaktuar përparësitë e interesave dhe qëllimeve të tyre personale
Kapitulli 2 Përgjegjësia	Cilat janë pasojat e vendimeve të mia? Cili është prioriteti im në një dilemë? Cilat janë vlerat dhe parimet që unë zgjedh si bazë e veprimit tim?	për të marrë përgjegjësi në trajtimin e dilemave – mbledhja e informacionit, shqyrtimi i pasojave, përcaktimi i prioritetëve, zgjedhja
Kapitulli 3 Diversiteti dhe pluralizmi	Cilat janë interesat e mia? Çfarë kompromisi mund të sugjeroj?	për të negociuar kompromise të drejta dhe efikase në mjedise pluraliste dhe konkurruese

	Çfarë përcaktojmë ne si të mirën e përbashkët?	
Kapitulli 4 Konflikti	Cili është problemi? Çfarë interesash janë përfshirë? Çfarë zgjidhje është e dëshirueshme dhe e realizueshme?	për të zgjidhur konfliktet e interesit me mjete jo të dhunshme
Kapitulli 5 Rregullat dhe ligji	Çfarë rregullash na nevojiten për të qeverisur sjelljen tonë? Me çfarë rregullash mund të biem ne dakord?	për të vlerësuar funksionin e kuadrit institucional - kushtetutat, ligjet, rregullat dhe vlerat e përbashkëta
Kapitulli 6 Qeverisja dhe politika	Cilat çështje janë marrë përsipër dhe janë përjashtuar nga agenda politike? Çfarë problemi është në diskutim? Cila është zgjidhja, dhe si është zbatuar?	për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes demokratike - brenda dhe jashtë institucioneve
Kapitulli 7 Barazia	Cilat janë interesat e shumicës dhe pakicës? Çfarë kompromisi mund të sugjeroj? Çfarë duhet të pranojë pakica? Në çfarë mënyre janë të mbrojtur nga të drejtat e njeriut interesat e një grupi?	Për të mbështetur kohezionin shoqëror, duke balancuar interesat e grupeve të shumicës dhe të pakicës
Kapitulli 8 Liria	Cila është pika ime kyç? Cila është strategjia ime e argumentimit? Cila është strategjia e kundërshtarit tim?	për të ushtruar lirinë e mendimit dhe të fjalës, nëpërmjet shkathësisë të tyre argumentuese
Kapitulli 9 Mediet	Kujt dua t'i drejtohem unë? Cili është qëllimi im? Cili është mesazhi im? Ku mund ta gjej informacionin?	për të përdorur potencialin e komunikimit përmes medias

4. "Qasja evropiane" e EQD / EDNJ

Për më se një dekadë, Këshilli i Evropës ka iniciuar zhvillimin dhe zbatimin e EQD / EDNJ në vendet e saj anëtare. Koordinatorë, ekspertë, mësues dhe trajnues të EDC, nga shumë shtete anëtare, kanë marrë pjesë në diskutime që kanë nxitur redaktorët dhe autorët për të prodhuar këtë seri prej gjashtë vëllimesh për mësuesit.

EQD / EDNJ mbështet një "qasje evropiane" për të mësuarit për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut. Në kontekstet specifike të shkollave dhe të sistemeve tona të arsimit, traditat tona të mësimdhënies dhe të mësuarit, dimensionet e mësimdhënies "rreth" dhe "për" demokracinë dhe të drejtat e njeriut mund të ndryshojnë. Por ne ndajmë mendimin se EQD / EDNJ shërben si një udhëzues pedagogjik për shkollën në tërësi. Ne jemi dakord që në EQD / EDNJ metoda mbart mesazhin - mësim përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Me këtë botim të EQD / EDNJ, redaktorët dhe autorët përpiqen të korrin të mbjellat e procesit të EQD / EDNJ në Këshillin e Evropës. Burimet e mbështetjes që unë kam marrë, kur shkruaja këtë manual, reflektojnë "qasjen evropiane". Në veçanti, dëshiroj të përmend si më poshtë vijon.

Znj Manuela Droll dhe Znj Karen O'Shia ishin bashkautorët e mi në krijimin e versionit pararendës të këtij manuali për trajnimin e mësuesve të EQD në Bosnjë dhe Hercegovinë. Z.

Emir Adzovic, koordinatori i Këshillit të Evropës për projektin EQD / EDNJ në Bosnjë e Hercegovinë, ofroi kuadrin organizativ për projektin tonë. Ne e zhvilluam kornizën e koncepteve kyçe me Z. Don Rowe, Z. Ted Huddleston dhe Z.Wim Taelman. Doni lexoi disa nga draftet tanë të parë, dhe Ted ishte një nga partnerët tanë më të rëndësishëm, kritikë dhe konstruktiv gjatë diskutimeve.

Znj. Olof Olafsdottir dhe Znj. Sarah Keating-Chetuind ishin partneret dhe koordinatorët tona për këtë projekt në Këshillin e Evropës. Ata e kanë vlerësuar këtë projekt në tërësi me durim dhe vendosmëri.

Peti Wiskemann e ka pasuruar këtë manual me imazhin e kapakut që mundëson komente të pasura dhe nxitëse për temat kryesore në të nëntë kapitujt, si dhe për konceptet kyçe përkatëse. Ms Eiltrud Eidinger dhe Z. Rolf Gollob më mbështetën si bashkë-redaktorë dhe partnerë në diskutimet e panumërta.

Bashkëpunimi im me Z Christian Fallegger bie në sy në disa aspekte. Ai ka diskutuar me mua gjatë fazave të hershme të shkrimit, duke kontribuar me ide dhe sugjerime të vlefshme, si dhe me reagimet e tij kritike dhe konstruktive në vazhdimësi.

Pa mbështetjen dhe frymëzimin e të gjitha këtyre kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe miqve unë nuk do të mund ta shkruaja këtë libër. Unë jam thellësisht mirënjohës për të gjithë ata; megjithatë, unë mbetem përgjegjës i vetëm për ndonjë defekt ose gabim që lexuesi mund të gjejë në të.

Peter Krapf
Zyrih dhe Ulm,
Dhjetor 2009

Të mësuarit ndërveprues konstruktivist në EQD/EDNJ

Plani

- 1. Pyetjet kyçe për didaktikën në EQD/EDNJ**
- 2. Një shembull i të mësuarit ndërveprues konstruktivist - nxënësit e rinj imagjinojnë botën e tyre ideale**
- 3. Çdo person mëson ndryshe - "Ne krijojmë botën në mendjet tona"**
- 4. Të mësuarit konstruktivist dhe ndërveprimi shoqëror**
- 5 Cili është roli i mësuesit në proceset e të mësuarit konstruktivist?**
- 6. Cili është roli i mësuesit në EQD/EDNJ?**
 - 6.1 Mësuesi si lektor dhe instruktor - për të mbështetur dhe pasuruar ndërtimin e dijes**
 - 6.2 Mësuesi si kritik dhe korigjues - për të mbështetur analizën**
 - 6.3 Mësuesi si krijues dhe ofrues të detyrave të zbatimit - për të mbështetur ndërtimin e dijes**
 - 6.4 Mësuesi si drejtues në seancat plenare - për të mbështetur të gjitha format e të mësuarit konstruktivist**
- 7. Demokracitë si komunitetet e nxënësve - një qasje konstruktiviste ndaj koncepteve kyçe në EQD/ EDNJ**

Të mësuarit ndërveprues konstruktivist në EQD / EDNJ

1. Pyetjet kyçe për didaktikë në EQD / EDNJ

Në EQD / EDNJ, sikundër në mësimdhënien në përgjithësi, është e rëndësishme që mësuesi të reflektojë për objektivat dhe të qartësojë arsyet për zgjedhjet që duhet të bëhen në mënyrë të pashmangshme dhe për prioritetet që duhet të vendosen.

1. Çfarë duhet të mësojnë nxënësit në EQD / EDNJ?

Nxënësit duhet të mësojnë si të marrin pjesë, si qytetarë, në komunitetin e tyre demokratik. Ata kanë nevojë për të zhvilluar:

- kompetencat e analizës dhe të gjykimit politik, kur kanë të bëjnë me probleme dhe çështje politike;
- Kompetencat e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse politike;
- një repertor të aftësive metodike.

2. Pse dhe për çfarë duhet t'i fitojnë nxënësit këto kompetenca?

Demokracia varet nga qytetarët që janë të gatshëm dhe në gjendje të marrin pjesë në vendimmarrje dhe për të marrë detyra në institucionet e saj. Nxënësit duhet t'i kenë këto kompetenca dhe aftësi për të qenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe civile dhe për të kryer rolet e tyre si qytetarë aktivë ("**të mësuarit për**" demokracinë dhe të drejtat e njeriut).

3. Kjo ngre një pyetje të mëtejshme. Nëse kjo është ajo që duhet të mësojnë qytetarët e rinj - në drejtim të rezultateve të të mësuarit - çfarë duhet të **bëjnë** mësuesit e EQD / EDNJ për të siguruar këtë? Mësuesit EQD / EDNJ duhet të japin të dhëna për të mbështetur nxënësit e tyre:

- njohuri dhe të mësuar konceptual - "**të mësuarit rreth**" demokracisë dhe të drejtave të njeriut;
- trajnimi i aftësive;
- mësuesit duhen të japin shembuj për t'u ndjekur dhe mjedise mësimore për qëndrime dhe vlerat që janë mbështetëse të një kulture demokratike (toleranca, respekti i ndërsjellë, vlerësimi i të drejtave të njeriut) - "**të mësuarit përmes**" demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

4. Tri pyetjet e mësipërme tashmë janë trajtuar në hyrje të këtij manuali. Megjithatë, mbetet ende një pyetje e rëndësishme: **si** mësojnë nxënësit në EQD / EDNJ?

Si mësues të EQD / EDNJ, ne duhet të kuptojmë si zhvillohen proceset e të mësuarit të nxënësve tanë dhe si mund t'i mbështesim ato. Për t'iu përgjigjur pyetjes si mësojnë nxënësit tanë, ne kemi zbatuar një kuadër konceptual të të mësuarit konstruktivist ndërveprues. Me këtë qasje, ne e lidhim "të mësuarit përmes" demokracisë dhe të drejtave të njeriut në orët e EQD / EDNJ me proceset vendimmarrëse politike në demokraci. Proceset e vendimmarrjes në demokraci janë, në thelb, procese kolektive të të mësuarit. Kjo është arsyeja pse Xhon Djui e konceptonte shkollën "si një komunitet në miniaturë, si një shoqëri embrionale".² Në këtë kapitull ne kemi

² John Dewey, *The School and Society*, New York, 2007, p.32

paraqitur të kuptuarit tonë për të mësuarit konstruktivist ndërveprues. Ne besojmë se ajo ndihmon mësuesit të EQD / EDNJ për të kuptuar më mirë:

- proceset e të mësuarit të nxënësve të tyre në EQD / EDNJ;
- rolin e tyre për të mbështetur nxënësit e tyre në procesin e mësimit;
- se vendimmarrja demokratike është një proces i të mësuarit kolektiv.



Mësimdhënia dhe të mësuarit në EQD / EDNJ dhe politika në demokraci mund të dyja të perceptohen nga një këndvështrim konstruktivist. Kjo është e mundur dhe e dobishme për shkak të analogjive strukturore të të mësuarit konstruktivist dhe të vendimmarrjes demokratike. Të dyja, mësimi i EQD / EDNJ edhe komunitetet demokratike janë, ose të paktën duhet të jenë, komunitete të të mësuarit të qeverisura nga të drejtat e njeriut. Prandaj, konstruktivizmi ndërveprues përforcon qasjen themelore të EQD / EDNJ - mësim **përmes, për dhe rreth** demokracisë dhe të drejtave të njeriut: ajo është mësimdhënie e mirë, që i shërben të drejtave të njeriut, duke mbështetur edhe nevojat e të mësuarit të nxënësve dhe qytetarëve.

Teoria paraqitet më mirë nëpërmjet një shembulli konkret. Pjesa në vijim, ilustron potencialin e të mësuarit konstruktivist ndërveprues në edukimin e të drejtave të fëmijëve.

2. Një shembull i të mësuarit konstruktivist ndërveprues - nxënës të rinj imagjinojnë botën e tyre ideale

Vëllimi V i kësaj serie të EQD / EDNJ, *Eksplorimi i të drejtave të fëmijëve*, përfshin një kapitull me katër mësim për nxënësit e klasës së tretë, me titull, "Ne jemi magjistarë!"³ Ai nxit nxënësit për të shprehur dëshirat dhe idetë e tyre si duhet të jetë bota dhe, në diskutimin në vijim, ata hulumtojnë vlerat morale dhe politike që qëndrojnë në themel të dëshirave të tyre për botën e ardhshme. Mësimi i parë fillon në mënyrën e mëposhtme:

"Mësuesi vizaton dy persona në dërrasë: një grua ose një burrë dhe një magjistar.

Hunger		
Poverty		
Boredom		
Birthday		

Në dyshe, fëmijët duhet të vizatojnë dy figura dhe të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme së bashku:

- Çfarë bën një njeri i zakonshëm në situata të caktuara?
- Çfarë bën magjistari në të njëjtat situata?

³ Rolf Gollob / Peter Krapf, EQD/EDNJ, Volume V: *Exploring children's rights*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2007, "We are wizards!", pp. 22-26; c.f. EQD/EDNJ Volume VI, *Teaching democracy*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2008, Exercise 6.3, "If I were a magician", p. 59.

Pas disa minutash, mësuesi mbledh nxënësit në një gjysmërreth përballë dërrasës së zezë për t'i mundësuar çdo fëmijë një pamje të mirë (në klasa të mëdha, mund të jetë i nevojshëm një gjysmërreth i dyfishtë). Mësuesi i mbledh të gjitha përgjigjet e nxënësve në një listë në dërrasë - pa komentuar ose gjykuar. Ne sugjerojmë tabelën e mëposhtme për të integruar idetë e nxënësve.

Ne shikojmë zgjidhjet dhe i lejojmë fëmijët të bëjnë komentet e tyre. Sigurisht, tani do të dalin pyetje! Mësuesi dëshiron të dijë:

- A mund të dalloni ndonjë zgjidhje ose ide që është bërë nga një magjistar i mirë apo një i keq?
- Kur keni dëshiruar për herë të fundit të ishit magjistar dhe çfarë dëshironit të ndryshonit atëherë?
- Cila është dëshira juaj më e madhe tani?

Mësuesi i nxit nxënësit të dalin përpara me idetë e tyre dhe u jep të gjithëve mbështetje pozitive.

Ky shembull tregon disa aspekte të rëndësishme, se si nxënësit dhe mësuesit bashkëveprojnë në mjediset e të mësuarit konstruktivist:

Mësuesi ...	Nxënësit ...
<p>... cakton një detyrë të hapur që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërkon nga nxënësit që të kaloni perspektiva (realiteti-utopia); - Mbështet lirinë e mendimit dhe shprehjes së nxënësve. <p>... mbledh idetë e nxënësve në tabelë;</p> <p>... shton struktura (fjalë kyçe dhe koncepte);</p> <p>... improvizon, duke reaguar ndaj ndërhyrjeve të nxënësve;</p> <p>... bën pyetje për të ndihmuar nxënësit të shqyrtojnë arsyet dhe pasojat e ideve të tyre;</p> <p>... inkurajon nxënësit dhe i jep reagime pozitive....</p>	<p>... zhvillojnë dhe ndajnë idetë e tyre;</p> <p>... shprehin dhe shkëmbejnë idetë e tyre; (në shembull, idetë e tyre kanë një dimension personal dhe politik)</p> <p>... mendojnë për dëshirat dhe përvojën e tyre në lidhje me kufijtë dhe kufizimet e këtyre dëshirave në jetën reale;</p> <p>... zbulojnë dallimin ndërmjet "mirës" dhe "të keqes" në magji.</p>

Një parim themelor i të mësuarit konstruktivist është se opinioni i nxënësit është i rëndësishëm. Në këtë rast:

Si e perceptojnë nxënësit botën ku jetojnë?

- Si e gjykojnë ata se çfarë po ndodh rreth tyre?
- Çfarë do të ndryshonin ata, në qoftë se do të mundeshin?
- Cili është shqetësimi i tyre kryesor – ai në krye të listës së tyre personale?
- Çfarë këndvështrimesh ndajnë ata në klasë - në çfarë pikash ndryshojnë?
- Është gjithashtu e qartë se nxënësit gjykojnë atë që po ndodh në botën e tyre dhe gjykimi i tyre ndikon fuqimisht në mënyrën si ata do të veprojnë dhe do të marrin pjesë.⁴

Në të mësuarit konstruktivist, nxënësit lejohen të veprojnë në rolin e ekspertëve. Rregullimet e mësuesit përqendrohen në njohuritë paraprake të nxënësit, në vend të asaj që ata *nuk* e dinë. Në rolin e magjistarit, çdo fëmijë mund të kontribuojë me një ide dhe për këtë ka asnjë standard "për të drejtën apo të gabuarën". Përkundrazi, arsyeja pse një fëmijë shpreh një vizion të caktuar është e rëndësishme – çfarë përvojat përfshihen në të? Çfarë e shqetëson fëmijën? Cilat janë dëshirat dhe

⁴ 4) EQD/EDNJ can, and therefore should, be taught to very young children. EQD/EDNJ Volume V begins with a unit for children at kindergarten level who have not yet learnt to read and write. See Unit 1, "I have a name – we have a school", pp. 13-16.

nevojat e djalit ose vajzës? Të mësuarit konstruktivist merr parasysh këndvështrimin individual të nxënësit dhe procesin e të mësuarit dhe të menduarit.

Të mësuarit konstruktivist është një ushtrim i të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve - liria e mendimit, e opinionit dhe e shprehjes; barazia e mundësive; parimet e njohjes reciproke dhe mosdiskriminimit; dhe e drejta për arsimim.

Në mjedisin e mësimit konstruktivist, detyra e mësuesit është të mbështesë nxënësit në shumë mënyra – ai siguron një strukturë që bazohet te detyra ose problemi, respekton të drejtat e lirisë dhe barazisë së nxënësve, jep udhëzime, inkurajon dhe udhëzon (konceptet). Mësuesi nuk e di përgjigjen që do të japin nxënësit, dhe është i gatshëm dhe i përgatitur për të punuar me të dhënat e tyre (improvizim). Nxënësit duhet të kenë mundësinë të ndajnë dhe të krahasojnë idetë e tyre, dhe, shpesh, tema ose detyra e tyre kërkon që të arrijnë një kuptim të përbashkët ose të marrin një vendim. Mësuesi vepron si lehtësues; ai mund të parashikojë, por nuk mund të paracaktojë rezultatet e proceseve të të mësuarit të nxënësve.

Të mësuarit konstruktivist mbështet më shumë zhvillimin e kompetencës se sa marrjen e një disa fakteve. Nga një këndvështrim konstruktivist, çdo kurrikul me bazë njohuritë mund të sfidohet, dhe është e dyshimtë nëse dikush mund të "mësojë" nga futja në kujtesë e fakteve të izoluar, pa i kuptuar dhe vlerësuar ato. Pjesa në vijim shqyrton këtë çështje në mënyrë disi më të detajuar. Ajo trajton disa aspekte të teorisë së mësuarit në konstruktivizmin ndëveprues dhe i lidh ato në një koncept konstruktivist të vendimmarrjes demokratike.

3. Çdo person mëson ndryshe - "Ne krijojmë botën në mendjet tona"

Kur ne lexojmë një histori në një libër, ne krijojmë diçka si një film në mendjen tonë. Ne shtojmë detaje dhe skena që autori na lë t'i kuptojmë ose i lë jashtë, ne madje mundet të imagjinojmë edhe fytyrat e personazheve. Disa romane na apelojnë kaq fort në imagjinatën tonë sa që ne jemi të zhgënjyer nëse ndonjëherë shikojnë një film "të vërtetë" të bazuar te historia. Imagjinata jonë kishte prodhuar një shumë më të mirë, dhe kjo është unike, sepse mendja e çdo lexuesit prodhon një "film" të ndryshëm.

Ky është një shembull i aftësive tona për të "krijuar botën në mendjen tonë". Bota në të cilën ne jetojmë është bota se si ne e perceptojmë - ajo përbëhet nga imazhe, përvojat, konceptet dhe gjykimet që kemi krijuar. Si nxënës, njerëzit duan t'i gjejnë kuptimin asaj që dëgjojnë ose lexojnë - ata duan ta kuptojnë atë. Një studiues i trurit e ka karakterizuar trurin e njeriut si një "makinë që kërkon kuptimin". Gjërat që nuk kanë kuptim duhet të zgjidhen njëfarësoj. Nëse informacioni mungon, ne ose duhet ta gjejmë atë ose të mbushim hapësirën me hamendësime. Stereotipat na ndihmojnë për të lehtësuar çështjet e komplikuar⁵.

Me përvojën e tij, mësuesi zbulon se kur jep leksion, çdo student merr dhe ruan një mesazh pak a shumë të ndryshëm. Disa nxënës do të vazhdojnë të kujtojnë informacionin edhe kur të jenë të rritur, sepse ajo i ka bërë më shumë përshtypje, të tjerët mund ta harrojnë deri në mëngjesin e ardhshëm për shkak se ajo nuk ishte kuptimplote për ta. Nga një perspektivë konstruktiviste, është e rëndësishme ajo që ndodh në mendjet e nxënësve.

Konstruktivizmi e koncepton të mësuarit si një proces shumë të individualizuar:

- Nxënësit ndërtojnë ose të krijojnë strukturat e kuptimit. Informacioni i ri është i lidhur me atë që një nxënës tashmë e di ose e ka kuptuar.
- Nxënësit të vijë në një orë të EQD / EDNJ me CV dhe përvojat e tyre individuale.

⁵ See Rolf Gollub / Peter Krapf (eds), EQD/EDNJ Volume III: *Living in democracy*, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2008, Unit 1, "Stereotypes and prejudices. What is identity? How do I see others, how do they see me?" pp. 19-38.

- Gjinia, klasa, mosha, përkatësia etnike apo besimi fetar i japin çdo nxënësi një këndvështrim unik. - Ne posedojmë forma të ndryshme të inteligjencës që shkojnë përtej të kuptuarit konvencional të të qenit mirë në matematikë apo në gjuhë.⁶
- Nuk ka asnjë standard absolut për aftësinë personale apo politike. Diçka bëhet problem për shkak se një person e përcakton që të jetë i tillë, dhe mendja e nxënësit zgjedh informacionin që do të mbahet mend apo harrohet.

⁶ See Howard Gardner's work on multiple intelligences

4. Të mësuarit konstruktivist dhe ndërveprimi shoqëror


Deri tani ne kemi parë në perspektivën individuale të nxënësit. Nxënësit kërkojnë kuptimin, por ata gjithashtu bëjnë edhe gabime. Si duhet të korrigjohen ato? Nga një këndvështrim konstruktivist, është nxënësi ai që duhet të analizojë çfarë është e gabuar dhe ta rindërtojë. Por, në Ç'mënyrë një nxënës individual bëhet i vetëdijshëm për gabimet që ka bërë? Kemi dy mënyra që nxënësi të kapërcejë defektet dhe gabimet.

Së pari, ne i zbulojmë vetë gabimet tona. Ne zbulojmë se zgjidhja jonë për një problem nuk ecën, ose se një linjë e argumentit nuk ka kuptim.

Së dyti, ne varemi nga të tjerët për të na treguar, dhe shpesh na ndihmojnë.

Prandaj të mësuarit konstruktivist nuk është vetëm një proces shumë i individualizuar. Ai ka gjithashtu një dimension të dytë, po aq të rëndësishëm, të mësuarit kolektiv. Nxënësit duhet të ndajnë idetë e tyre nëpërmjet ndërveprimit dhe komunikimit me njëri-tjetrin dhe me mësuesit e tyre. Për këtë arsye, ne e kemi quajtur konceptin tonë **të mësuarit ndërveprues konstruktivist**.

Diagrami i mëposhtëm ilustron nivelin individual dhe social të mësuarit konstruktivist; ky është dimensionin social i të mësuarit konstruktivist. Ai tregon se nxënësit i referohen gjithmonë botës jashtë mendjeve të tyre. Kur ata vënë në provë idetë dhe planet e tyre, është pikërisht bota e objekteve ajo që është pika e tyre e referimit. Ky është dimensionin subjekt-objekt i të mësuarit konstruktivist.



Dimensioni i të mësuarit dhe vendimarrja

Si nxënësit në klasë ashtu edhe qytetarët në një shtet demokratik ndërveprojnë si komunitete të nxënësve. Ne tashmë e kemi përmendur Xhon Djuin, i cili e koncepton shkollën "si një komunitet në miniaturë, si një shoqëri embrionale".⁷ Prandaj ndërveprimi që nxënësit përjetojnë në shkollë me njëri-tjetrin dhe me mësuesit e tyre është pjesë e jetës së vërtetë, dhe jo një marrëveshje artificiale për t'i përgatitur ata për jetën e vërtetë më vonë.

⁷ John Dewey, *The School and Society*, New York, 2007, p.32


Si në politikë edhe në shkollë, kemi gjithmonë të pranishëm anëtarët me nivele më të larta të përvojës, njohurive, të kuptuarit, dhe gjithashtu më me pushtet - mësuesit, udhëheqësit politikë, menaxherët, shkencëtarë dhe kështu me radhë. Megjithatë, në shoqëritë moderne asnjë prej këtyre lojtarëve nuk ushtron pushtet absolut. Demokracia dhe sundimi i ligjit (duhet) të vendosë kufij të kompetencave të çdo aktori, dhe këto kufizime janë pasqyruar nga ndarja e punës, duke i kufizuar që çdo lojtar të jetë specialist në një fushë të caktuar.

Megjithatë, ekziston një kërcënim serioz ndaj angazhimit demokratik se të gjithë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në demokraci. Sa më komplekse që bëhen shoqëritë dhe problemet tona aq më shumë qytetari si individ varet nga kompetencat e tij ose të saj për të marrë pjesë në demokraci. Më shumë se kurrë më parë, edukimi është bërë çelësi për pjesëmarrjen në komunitet nxënësve të rritur.

5 Cili është roli i mësuesit në proceset e të mësuarit konstruktivist?

Nxënësit kërkojnë kuptimin, dhe çdo nxënës e bën këtë në një mënyrë shumë të veçantë. Një nxënës e lidh informacionin e ri - një pjesë të informacionit, një leksion, një ide interesante në një libër, etj - në strukturat ekzistuese të njohurive dhe përvojës në mendjen e tij. Konstruktivizmi do të thotë që ne krijojmë sisteme dhe struktura të diturisë, të të kuptuarit dhe të përvojës sonë.

Nga një këndvështrim konstruktivist, trekëndëshi i mirënjohur didaktik merr një kuptim të ri:



Në marrëdhëniet trekëndore, njëra nga palët, ndonjëherë, mbetet e përjashtuar. Në proceset e të mësuarit konstruktivist, ai është mësuesi. Është nxënësi ai që krijon të kuptuarit e tij për objektet e të mësuarit. Ndërtimi i kuptimit ndodh në mendjen e nxënësit, përtej vargut të perceptimit të mësuesit. Ajo çfarë sheh mësuesi është rezultati - çfarë prodhojnë dhe si sillen nxënësit. Mësuesi sheh arritjet, jo kompetencën. Është pikërisht nxënësi, jo mësuesi, i cili do të vendosë, në fund të fundit, se çfarë është interesante dhe me vlerë për të mësuar për ta, të cilën, për këtë arsye, do ta kujtojnë për gjithë jetën ose ta harrojnë.

Të mësuarit konstruktivist mund të ndahet më tej në tri nënkategori dhe mësuesi luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e tyre.

1. Nxënësit **ndërtojnë (konstruktojnë)** kuptimin - ata zbulojnë dhe krijojnë diçka të re. Mësuesit mund të mbështesin nxënësit e tyre:
 - duke krijuar shanse për të mësuar;
 - duke hartuar detyra sfiduese;
 - duke ofruar udhëzime përmes medieve dhe leksioneve që përfaqësojnë objektet e të mësuarit;

- duke nxitur dhe mbështetur vetëvlerësimin e nxënësit;
2. Nxënësit **rindërtojnë** atë që kanë mësuar më parë - ata e zbatojnë dhe e testojnë. Në një masë të madhe, ne të gjithë krijojmë aplikacione të tilla vetë, por në shkollë, mësuesi i mundëson ato përmes:
 - dhënies së mundësisë për të ndarë, për të prezantuar dhe për të diskutuar;
 - testimin dhe vlerësimin;
 - detyrave dhe portofoleve;
 - detyrave sfiduese, për shembull, përfshirjes në projekte;
 3. Nxënësit **analizojnë** ose kritikojnë, rezultatet e tyre ose të njëri-tjetrit. Siç është shpjeguar më lart, pa këtë element të shqyrtimit kritik dhe të testimin, çdo përpjekje për të mësuar do të bëhet e padobishme për shoqërinë dhe për vetë nxënësin si individ.

6. Cili është roli i mësuesit në EQD / EDNJ?

Një element kyç i mësimdhënies dhe i të mësuarit është mënyra si nxënësit komunikojnë dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mësuesin. Kompetenca profesionale e mësuesit i mundëson atij që të reflektojë për pasojat e një aktiviteti të caktuar dhe të përdorë modelet e sjelljes si mjete. Mësuesi kryen role të ndryshme dhe këto janë më të diferencuara sesa në mësimin tradicional, të bazuar njëanshmërisht tek përmbajtja, sipas modelit: "shkruaj me shkumës dhe fol". Mësimdhënia e njëanshme është një ndër rolet e mësuesit, por kjo, në këtë rast, është më e rrallë. Përkundrazi, të mësuarit konstruktivist kërkon që mësuesi "të mësojë me gojën e mbyllur", duke i dhënë më shumë kohë dhe më shumë mundësi fjale nxënësve.

Seksionet e mëposhtme na përshkruajë katër rolet kryesore që një mësues kryen në mjediset konstruktiviste të të mësuarit:

1. Mësuesi si lektor dhe instruktor.
2. Mësuesi si kritik dhe korrigjues.
3. Mësuesi si krijues dhe ofrues i detyrave për zbatim.
4. Mësuesi si drejtues në seancat plenare.

Shembujt e përdorur në mësimet e këtij manuali ndihmojnë lexuesin të gjejë përshkrime të hollësishme të kontekstit në klasat e EQD/EDNJ.

6.1 Mësuesi si lektor dhe mësimdhënës - për të mbështetur dhe pasuruar konstruksionin

Një rregull bazë për një lektor është parimi "60:40"; 40 për qind, ndoshta më shumë, e çështjes për të cilën flet mësuesi duhet të jetë e njohur për nxënësit. Pa këtë shkallë të lartë të informacionit nuk është i mundur të mësuarit konstruktivist.

Në këtë manual, konceptet kyçe formojnë shtyllën kurriore didaktike, ashtu si edhe të kurrikulës së EQD/EDNJ. Këto koncepte duhet t'u bëhen të njohura nxënësve. Kjo do të thotë se mësuesi duhet të udhëzojë nxënësit përmes një leksioni ose një detyrë leximi, ose të dyja bashkë. Si nxënës konstruktivistë, ata duhet të kenë krijuar tashmë një kontekst të të kuptuarit, në të cilin ata do të përshtatin edhe udhëzimet e mësuesit. Në mënyrë tipike, kjo strukturë e hapur, e papërfunduar e kuptimit përbëhet nga pyetje ose përvoja që kanë nevojë për shpjegim. Tabela e mëposhtme tregon ku trajtohet roli i mësuesit si lektor dhe mësimdhënës në përshkrimet e mësimin të këtij manuali.

Kapitulli/konc epti kyç	Shembuj dhe referencat për materialet
Kapitulli 2 Përgjegjësia	Mësimi 4: Mësuesi zgjedh një temë që nxënësit kanë të fokusuar në diskutimin e tyre dhe jep një kuadër konceptual për reflektim. Materialet për mësuesit 2.3 mundëson modulet leksion për të mbështetur përgatitjen e mësuesit
Kapitulli 3 Diversiteti dhe pluralizmi	Mësimi 2: Mësuesi prezanton konceptin e së mirës së përbashkët (shiko materialet për mësuesit 3b).
Kapitulli 4 Konflikti	Mësimi 3: Nxënësit kanë raportuar për përvojën e tyre të konfliktit. Mësuesi i ndihmon ata për të kuptuar problemin që e shkaktoi këtë konflikt, duke prezantuar modelin e qëllimeve të qëndrueshmërisë (shih fletët e punës së nxënësit 4.2).
Kapitulli 4 Konflikti Kapitulli 5 Rregullat dhe ligji	Nxënësit kanë marrë pjesë në një ose dy lojëra vendimmarrjeje. Mësuesi i ndihmon ata për të reflektuar për përvojën e tyre në seancën dëgjimore, duke prezantuar konceptin e modernizimit (shih fletët e punës së nxënësit 5.5).
Kapitulli 6 Qeverisja dhe politika	Mësimi 2: Mësuesi prezanton modelin e ciklit të politikave (fletët e punës së nxënësit 6.1 dhe 6.2). Në një seancë dhënie mendimesh, gjatë mësimit të mëparshëm, nxënësit kanë diskutuar çështjen e përcaktimit të agjendës politike dhe janë tashmë të gatshëm për ta trajtuar këtë çështje.
Kapitulli 9 Media	Mësimi 1: nxënësit kanë shprehur preferencën e tyre për një lloj të caktuar gazete. Mësuesi i lidh deklaratat e tyre me konceptin e ruajtësit të portës. Jo vetëm media vepron si ruajtës porte, por edhe përdoruesit e bëjnë këtë gjithashtu. Mësimi 4: Nxënësit reflektojnë për rolin e tyre në ndërtimin e mesazheve të medieve. Mësuesi trajton dy pikat kyçe në prodhimin e lajmeve të medias: të gjitha mesazhet e medieve janë të ndërtuara me kujdes, dhe redaktorët dhe drejtuesit e medias dhe prodhuesit e lajmeve veprojnë si ruajtës të portave dhe përcaktues të rendit të ditës (shih materialet për mësuesit 9A).

6.2 Mësuesi si kritik dhe korrigjues - për të mbështetur destrukturimin

Në përshkrimet e mësimeve në këtë manual nuk përfshihen shembuj të rolit të mësuesit si kritik dhe korrigjues, për faktin që rastet për këto aspekte mund të lindin në çdo kohë dhe për këtë arsye nuk mund të parashikohen. Mësuesi duhet të kuptojë se çfarë duhet të bëhet si duhet. Megjithatë, disa udhëzime të përgjithshme ia vlen të diskutohen.

A është gabimi i rëndësishëm? Me fjalë të tjera, a është e nevojshme të korrigojen gabimet apo jo?

Preferenca për reagimet e nxënësve: do të kenë mundësi ata, për shembull, gjatë një prezantimi ose diskutimi, të zbulojnë dhe të korrigojnë gabimet më vonë?

Në rrethana të caktuara nxënësi duhet të korrigojë - analizojë - ndërtimin e kuptimit dhe të fillojë përsëri. Shembull: e tërë klasa do të mbështetet në paraqitjen e nxënësit.

Parimi i respektimit të ndërsjellë: ne mund të kritikojmë gabimet e njëri-tjetrit, por ne respektojmë personin. Kjo është e rëndësishme në mënyrë që nxënësit të mbështesin vetëvlerësimin dhe ta nxisin atë.

Kapitulli 8 krijon mundësinë e një debati ndërmjet nxënësve. Këtu, nxënësit vënë në provë argumentet e njëri-tjetrit dhe i analizojnë ato në rast se gjejnë ndonjë gabim.

6.3 Mësuesi si krijues dhe ofrues i detyrave të aplikimit - për të mbështetur rindërtimin

Mësuesi shpjegon se mësimi do të fillojë me një shembull. Ai shpërndan fletën e punës së nxënësit 7.1, dhe një nxënës lexon historinë me zë të lartë. Në fillim të një mësimi, kjo mënyrë e paraqitjes e mbledh klasën së bashku më mirë se leximi në heshtje.

Mësuesi drejton pyetjen:

"Cili është problemi?"

Ai u kërkon nxënësve të mendojnë për këtë pyetje për disa çaste dhe të shkruajnë përgjigjen. Kjo detyrë i jep "mendimtarëve të ngadaltë" (të cilët janë shpesh mendimtarë të kujdesshëm) ose më shumë nxënësve introvert (që mendon vetëm veten në qendër) një shans për të kontribuar në diskutim.

Në raundin plenar nxënësit japin kontributin e tyre, duke u bazuar në shënimet e tyre. Mësuesi dëgjon, dhe i inkurajon nxënësit të shpjegojnë idetë e tyre me saktësi ("të dëgjuarit aktiv"). Pasi flasin rreth 10 nxënës, mësuesi regjistron deklaratat kryesore në dërrasë. Pritet që nxënësit t'i referohen parimit kyç të demokracisë, i cili duket se punon në të mirë të grupit më të madh, ndërsa grupi më i vogël mund t'i referohet parimit të mos-diskriminimit (barazisë). Mësuesi i lidh idetë e nxënësve për këto kategori, të cilat më pas i strukturojnë dhe i qartësojnë në diskutim:

Një komunitet i vogël: klubi sportiv	
Problemi	Zgjidhjet e sugjeruara
Shkelja e të drejtave të barabarta Ndjenja e diskriminimit (shkelje e të drejtave të barabarta)	Interesat e pakicave duhet të respektohen (kompromis)
Fituesit dhe humbës e përhershëm (" shumica e vazhdueshme")	Lojtarët e shahut largohen nga klubi (skenari i dështimit)
Demokracia në pikëpyetje Shumica vendos - humbësit nuk pajtohen	Ndryshimi i përkufizimit të shumicës

2. Caktimi i detyrës

a. Problemi

Nxënësit ndoshta e kanë kuptuar se historia e rastit është një model që tregon problemet e shoqërisë dhe, për këtë arsye, çështja shumicë/pakicë ka një dimension politik. Duke studiuar një model në vend të realitetit, problemi bëhet më i qartë dhe detyra disi më të lehtë. Rezultatet e këtij studimi model mund të zbatohen – duke i krahasuar - me realitetin. Mësuesi e thekson këtë lidhje ndërmjet tregimit të rastit dhe realitetit, pasi kjo shpjegon qëllimin e detyrës.

Dy parime duhet të respektohen: **drejtësi dhe demokraci.**

Nga njëra anë, problemi shumicë/pakicë duhet të zgjidhet në mënyrë të drejtë - pakica nuk do të pranojë të qenit përgjithmonë nën dhunën e votës dhe duke parë interesat dhe nevojat e saj të lëna pas dore. Nga ana tjetër, demokracia do të thotë se shumica me të drejtë këmbëngul në marrjen e vendimit në duart e saj. Kështu që nxënësit duhet të hartojnë një statut që i afron këto dy parime së bashku.

Mësuesi shpërndan nxënësve fletët e punës 7.2 dhe 7.3 dhe u jep atyre kohë për të lexuar materialin 7.2 në heshtje. Në një raund të shkurtër plenar, nxënësit lidhin qasjet themelore të përcaktuara në broshurat e nxënësve 7.2 me idetë e tyre në dërrasën e zezë.

b. Zgjidhja e pritshme

Nxënësit duhet të dinë se çfarë pritet të ofrojnë. Në grupe të vogla, nxënësit do të zhvillojnë një projekt-statut që ofron rregulla për të kapërcyer skenarin e një "minoriteti të vazhdueshëm", i cili është gjithmonë i mbivotuar nga kundërshtari. Ato mund të përfshijnë rregulla për marrjen e vendimeve, ndoshta edhe rregullat për ndarjen e fondeve. Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin se klubi sportiv është një mikro-komunitet dhe statuti i tyre i ngjan kushtetutës së shtetit. Mësues dhe nxënës i referohen fletës së punës 7.3 për të sqaruar pyetje të mëtejshme.

c. Procedura

Së fundi mësuesi shpjegon aspektet teknike të detyrës. Nxënësit formojnë grupe. Menaxherët e burimeve thirren për të marrë lapustilët dhe tabelat dhe mësuesi i informon menaxherët e kohës që të kujdesen që grupet të jenë gati deri në fund të mësimit të dytë.

Mësuesi e ka kopjuar listën e pyetjeve kyçe të fletës së punës së nxënësve 7.3 për një tabelë (shih mësim 3 më poshtë). Ai u shpjegon nxënësve se këto pyetje të rëndësishme do të jenë lista e kontrollit për të gjykuar dhe krahasuar idetë e nxënësve.

3. Puna në grup

Nxënësit formojnë grupe me nga 4-6 veta. Ata përdorin kohën e mbetur në mësimin e parë dhe vazhdojnë me mësimin e dytë.

Mësuesi mund t'i kërkojë menaxherëve të ekipit për të takuar atë në fund të mësimit, për një konferencë për përparimin e grupeve.

Mësimi 2

Si mund të balancojmë interesat e shumicës dhe të pakicës?

Hartimi i një statuti për një mikro-komunitet

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësimor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Punë në ekip, menaxhimi i kohës. Zgjidhja e një problemi.
Objektivat e të mësuarit	Rregullat, ligjet dhe kushtetuta janë mjete për të zgjidhur problemet dhe merren me burimet e konfliktit në shoqëri. Ky është justifikimi për qeverinë dhe autoritetin. Megjithatë, ato mund t'i shërbejnë edhe interesave të caktuara.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit hartojë një projekt statut për t'u marrë me çështjen shumicë/pakicë në një mikro-komunitet.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 7.1.-7.3. Tabakë letre dhe markera.
Metoda	Punë në grupe.
Koha në dispozicion	40 min

Përshkrimi i mësimit

Nxënësit vazhdojnë punën e tyre në grupe.

Mësuesi i vështron ata në punë, duke parë se cilat metoda dhe aftësi kryejnë më mirë dhe ku kanë nevojë për trajnime dhe ndihmë të mëtejshme. Mësuesi mund të kërkojë dhe të japë komente se si nxënësit bashkëpunuan në seancën e raportimit (Mësimi 4). Grupet duhet të punojnë të vetëm sa më shumë të jetë e mundur dhe mësuesi nuk duhet të ndërhyjë nëse nxënësit janë "duke bërë gabime". Ata do të mësojnë më shumë, në qoftë se u jepet liria dhe përgjegjësia për të zbuluar vetë gabimet e tyre dhe, nëse është e nevojshme, klasa do t'i korrigjojë shumicën e gabimeve në raundin plenar.

Mësuesi duhet të përmbahet nga ndërhyrja në qoftë se një grup gjen një zgjidhje "politikisht jo korrekte", si p.sh dorëzimi i të gjithë kompetencave e vendimeve të një personi të vetëm ("zgjidhje diktatoriale"). Këtu përsëri, kjo ofron reagime interesante për diskutim. Shumë shpesh, nxënësit do të sfidojnë një arsyetim jo të shëndoshë apo të papranueshëm. Mësuesi vlerëson arritjet e nxënësve në zhvillimin e kompetencave dhe nxjerr përfundime për nevojat e tyre të të mësuarit.

Mësimi 3

Draft statute

Krahasimi i ideve në projektin institucional për zgjidhjen e problemit shumicë/pakicë

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Dhënia e prezantimeve të shkurtra, duke krahasuar dhe gjykuar idetë dhe arsyetimet.
Objektivat e të mësuarit	Dizajni institucional përfshin kritere të tilla si fizibiliteti, drejtësia dhe stabiliteti.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit shqyrtojnë kriteret e dizajnit institucional. Ata japin prezantime dhe krahasojnë idetë e tyre.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 7.4 Matrica për prezantimet e nxënësve (dërrasë të zezë ose tabelë). Pesë fletët A4me lapustila për grup; tub zamke ose shirit ngjitës.
Metoda	Prezantime në group, diskutime plenare.
Koha në dispozicion	1. Prezantime: projekt statuti për klubin sportiv. 30 min
	2. 10 min

Informacion

Ky mësim i kushton pjesën më të madhe të kohës të folurit me nxënësit. Grupeve u jepet mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre (pjesëmarrje), me kusht që prezantimet e tyre të janë të gatshme dhe folësit të respektojnë afatin (efikasitetin). Pjesëmarrja varet nga efikasiteti. Puna me efikasitet është një parakusht për të marrë pjesë në demokraci. Për këtë arsye, trajnimi i aftësive metodike është i rëndësishëm në EQD/EDNJ.

Përshkrimi i mësimit

1. Prezantimet e nxënësve

Mësuesi përshkruan agjendën: folësit e grupit japin prezantimet e tyre, duke iu referuar pyetjeve kryesore në fletën e punës së nxënësve 7.3. Këto pyetje rishfaqen në matricë. Ato i referohen kritereve të projektimit institucional - fizibilitetit, drejtësisë, stabilitetit.

Mësuesi vizaton matricën në tre tabela apo në dërrasën e zezë. Për të reduktuar kohën e shkrimit, mësuesi ngjit fletë të madhësisë A4 në matricës që tregon pyetjet kryesore. Ky është edhe një demonstrim i metodës së prezantimit që nxënësit do të përdorin.

Pyetjet kyç	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Krahasimi
Shpërndarja e fondeve: si?					
Kush e vendos shpërndarjen?					
Autonomia për grupet?					
Mos diskriminimi?					
...					

Secili grup ka deri në gjashtë minuta për prezantimin e saj. Grupet paraqesin rezultatet e tyre me radhë. Mësuesi drejton sesionin e prezantimeve. Nxënësit nuk duhet të fillojnë diskutime para se të dëgjohen të gjitha prezantimet. Megjithatë, prezantuesit duhet të shpjegojnë arsyet për sugjerimet e grupit të tyre.

Mësuesi inkurajon prezantuesit të përballen me klasën dhe jo të krijojnë kontakt me sy vetëm me mësuesin.

Një anëtar i ekipit të dytë është përgjegjës për regjistrimin e informacionit. Ky nxënës bën shënime të shkurtra në seksionet e parashikuara në dërrasën e zezë ose, mundësisht, në tabelë (mund të përdoret edhe fletë transparente). Nxënësit marrin shënime në Fletët e punës se tyre. Këto të dhëna sigurojnë materialin për diskutim në mësimin e ardhshëm.

Mësuesi inkurajon prezantuesit për të shpjeguar arsyet për sugjerimet e grupit të tyre.

2. Krahasimi i draft-statuteve

Nxënësit krahasojnë modelet para se t'i gjykojnë ato. Ndërkohë që prezantimet e grupit strukturohen vertikalisht në kolona e, përgjigjet e pyetjeve kyçe në vijim, nxënësit kalojnë në leximin e matricës në rreshtat horizontalisht, duke krahasuar përgjigjet e grupeve ndaj një pyetje të veçantë kyç. Në kolonën e fundit, mësuesi, i cili kryeson këtë fazë të mësimit, vëren konstatimet e nxënësve.

Nxënësit mbajnë shënimet e tyre në Fletën e punës së nxënësve 7.4.

3. Detyrat e shtëpisë - përgatitja e të dhënave për diskutim

Mësuesi i shpjegon nxënësve se duhet të fillojnë mësimin e ardhshëm me të dhënat (inputet) e tyre. Cila nga projekt-statutet është më bindës, sipas mendimit të tyre dhe për çfarë arsyesh?

Fleta e punës së nxënësit 7.4 ofron pyetjet kyçe për të gjykuar statutin, u jep nxënësve udhëzime si t'i përdorin këto pyetje dhe shpjegon edhe qëllimin e tyre në EQD/EDNJ.

Mësimi 4

Cila është mënyrë e mirë për të qeverisur një komunitet demokratik?

Çfarë është e drejtë, dhe atë që punon?

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësimor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Gjykimi: balancimi i kriterëve.
Objektivat e të mësuarit	Dialektika ndërmjet demokracisë, drejtësisë dhe efikasitetit.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit gjykojnë projekt-statutet dhe shpjegojnë arsyetimin e tyre.
Materialet dhe burimet	Dërrasa e zezë ose tabela.
Metoda	Prezantime, diskutim.
Koha në dispozicion	1. Nxënësit ndajnë dhe paraqesin rezultatet e tyre. 20 min
	2. Diskutim. 10 min
	3. Përfundim. 10 min

Informacion

Nxënësit ndajnë rezultatet e tyre dhe punojnë për një deklaratë të përbashkët nga të gjithë ("sistemi i ortekut"). Kjo qasje i përfshin të gjithë nxënësit, në vend që të dëgjojë vetëm disa nxënës të veçantë dhe të injorojë shumicën.

Përshkrim mësim

1. Nxënësit ndajnë dhe paraqesin rezultatet e tyre

Mësuesi kërkon fillimisht që nxënësit të votojnë për një statut të caktuar (ose për asnjë) me anë të votimit me duar. Pastaj, nxënësit me të njëjtat mendime formojnë grupe me katër ose pesë vetë. Ata ndajnë rezultatet e tyre dhe punojnë për një deklaratë. Pastaj grupet ofrojnë një deklaratë të shkurtër për arsyet e zgjedhjes së tyre (shih Fletën e punës së nxënësve 7.4).

2. Diskutimi

Pasi nxënësit kanë votuar për statutet e ndryshme, ata kanë pikëpamje të ndryshme se si do të gjykojnë modelet e grupit. Në diskutim, ata pyesin në mënyrë kritike zgjedhjet e njëri-tjetrit. Mësuesi drejton diskutimin. Në fund të diskutimit, nxënësit votojnë edhe një herë tjetër. A ka patur ndonjë grup sukses për të bindur tjetrin? A voton shumica e nxënësve për një statut të veçantë?

3. Përfundime

Mësuesi njofton qëllimin e fazës përmblyëse: nxënësit shohim procesin e tyre të të menduarit dhe rezultatin e tij nga një tjetër këndvështrim, me qëllim që të vlerësojnë rëndësinë e saj.

Mësuesi i drejton një pyetje: në çfarë mënyrë ky rast studimi për një klub të vogël sportiv i ngjan politikës?

Nxënësit shkëmbejnë mendimet me njëri-tjetrin dhe me mësuesin. Mësuesi dëgjon dhe thekson idetë që mbështesin ose kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Mësuesi përmbledh diskutimin, duke shtuar pikën e mëposhtme.

Në politikë, diskutimet për çështje të tilla komplekse nuk janë akademike, por praktike. Një komunitet duhet të bëjë një zgjedhje - ai ka nevojë për një ligj, si kuadër kushtetues. Pra, pas analizës së alternativave të ndryshme dhe alternativave me pikat e forta dhe me të meta, duhet të merret një vendim - në mënyrë ideale me votë unanime ose me një maxhorancë sa më të madhe që të ketë mundësi. Në politikë, një diskutim për këto çështje korrespondon me procesin e legjislacionit ose edhe me vendosjen për një kushtetutë.

Zgjerim: detyrë kërkimore

Në këtë kaptull, nxënësit kanë marrë një model për të analizuar një element të rëndësishëm të kushtetutës së tyre dhe të sistemit legjislativ, duke iu përgjigjur edhe pyetjes se si është ndërtuar dhe se si funksionon ajo në realitet. Ata kryejnë kërkime për pyetjet e mëposhtme:

1. Cilat janë problemet e shumicës/pakicës në shoqërinë tonë?
2. Studim rasti: si e zgjidh kushtetuta dhe sistemi ynë i ligjeve këtë çështje të veçantë?
3. Cili është gjykimi ynë në zgjidhjen?

Pjesa 3

Pjesëmarrja në politikë:

Pjesëmarrja përmes

komunikimit

Kapitulli 8: Liria

Debati në publik

Pse liria (e fjalës) nuk vepron pa rregulla strikte?

Kapitulli 9: Mediat

Pjesëmarrja në demokraci përmes medias

**Prodhuesit dhe përdoruesit e mediave si kontrollorë dhe përcaktues të
axhendës**

KAPITULLI 8

LIRIA

Arsimi i mesëm

Debati në publik

Pse liria (e fjalës) nuk vepron pa rregulla të ngurta?

8.1 Cilat janë çështjet që na interesojnë?

Nxënësit marrin pjesë në planifikimin e debatit

8.2 Përgatitja për debat

Deklaratat kryesore dhe strategjitë e debatit

8.3 Ne debatojmë - ne vendosim - ne raportojmë

Debati dhe vendimmarrja në publik

8.4 Një debat – këndvështrime të ndryshme

Nxënësit reflektojnë për debatin

Kapitulli 8

Liria

Debati në publik

Pse liria (e fjalës) nuk vepron pa rregulla të ngurta?

Hyrje për mësuesit

Pse liria (e fjalës) nuk vepron pa rregulla të ngurta?

Për disa lexues, kjo pyetje mund të duket e çuditshme. Në fund të fundit, liria do të thotë që ne mund të themi dhe të bëjmë atë që duam. Demokracia është një sistem për shoqëritë e hapura, të lira. Rregullat e ngurta na kujtojnë diçka shumë të ndryshme, për shembull, sundimin autoritar. Pra, cili është mesazhi prapa kësaj pyetjeje? E thënë shkurt, liria dhe barazia janë binjakë. Të gjithë ne i gëzojmë të drejtat e lirisë, por ne kemi nevojë edhe për shanse të barabarta për t'i ushtruar ato - dhe kjo është ajo për të cilën janë rregullat. Në këtë kapitull, nxënësit do të përjetojnë rëndësinë e këtij parimi për të marrë pjesë në demokraci.

Pse ky kapitull përqendrohet në debatimin

Qytetarët që marrin pjesë në demokraci do të marrin pjesë në diskutime dhe debate, dhe duke bërë këtë, ata do të ushtrorjnë të drejtat e tyre njerëzore për mendimin dhe shprehjen e lirë. Argumentimi në publik është një aftësi që mund të mësohet, kështu që nxënësit kanë nevojë për trajnim në shkollë. Për këtë arsye, nxënësit trajnohen se si për të kryejnë një debat dhe ky kapitull është e lidhur me konceptin kryesor të lirisë. Liria e fjalës dhe e shprehjes këtu është veçanërisht e rëndësishme.

Çfarë bëjnë nxënësit në mësimin e debatit

Njëmbëdhjetë nxënës marrin pjesë në debat. Kemi dy ekipe debati, me pesë nxënës secili dhe një kryetar. Nxënësit e tjerë dëgjojnë debatin, por edhe ata luajnë një rol aktiv. Tre ekipe dyshe nxënësish shkruajnë një histori për debatin dhe e raportojnë në klasë në mësimin e fundit të kapitullit. Nxënësit e mbetur veprojnë si një audiencë dhe roli i tyre është të vlerësojnë argumentet, të vendosin se cila palë i ka bindur në fund dhe të votojnë se cilën palë mbështesin. Si në politikë, një palë fiton shumicën e mbështetësve.

Çfarë do të mësojnë nxënësit në këtë kapitull?

Debati vijon me rregulla të rrepta që sigurojnë që çdo nxënës të marrë një kohë të folurë të drejtë dhe të barabartë. Pra, kryesuesi do të ndërpresë nxënësit që do dëshironin të flasin më gjatë se sa lejohet për të. Por, ky rregull është i domosdoshëm, pasi ai mbron të drejtën e çdo folësi ndaj shprehjes së lirë, por brenda një afati të kufizuar. Kjo është arsyeja pse liria nuk vepron pa rregulla të ngurta (shiko nëntitullin e këtij kapitulli. Pa këtë parim, asnjë sistem demokratik nuk do të punojë, as edhe të drejtat e njeriut nuk do të thoshin shumë në jetën e njerëzve.

Cila është detyra e mësuesit në këtë kapitull

Në këtë kapitull, nxënësit i është dhënë shumë kohë për të punuar më vete për të trajnuar aftësitë e tij që të debatojë dhe të vëzhgojë, por edhe për të marrë përgjegjësi për atë që bën. Mësimet 2-4 fillojnë me të dhëna të nxënësve. Kur nxënësit punojnë më vete, mësuesi vepron si një trajner: ai vështron nxënësit për të zbuluar se çfarë mund të bëjnë mirë dhe se cila anë e kompetencave të tyre ka nevojë për më shumë vëmendje dhe trajnim. Ai i mbështet nëse kërkojnë ndihmë, por nuk duhet t'u japë atyre zgjidhjet e detyrave.

Zhvillim kompetencash: lidhje me kapitujt e tjera në këtë vëllim

Çfarë na tregon kjo tabelë?

Titulli i këtij manuali, *Pjesëmarrja në demokraci*, përqendrohet në kompetencat e qytetarit aktiv në demokraci. Kjo matricë tregon potencialin e efekteve të sinergjisë midis njësive të këtij manuali. Matrica tregon se çfarë kompetencash janë zhvilluar në njësinë 8 (rreshtat e errësuar në tabelë). Kolona me kornizë të theksuar tregon kompetencat e vendimmarrjes dhe veprimit politik- e theksuar për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me pjesëmarrjen në demokraci. Rreshtat e mëposhtme tregojnë lidhjet me kapitujt e tjera në këtë manual: çfarë kompetencash janë zhvilluar në këto kapitull që mbështesin nxënësit në njësinë 8?

Si mund të përdoret kjo tabelë?

Mësuesit mund ta përdorin këtë matricë si një mjet për planifikimin e orëve të tyre EQD/EDNJ në mënyra të ndryshme.

- Kjo matricë ndihmon mësuesit të cilët kanë vetëm pak orë në dispozicion për EQD/EDNJ: një mësues mund të zgjedhë vetëm këtë kapitull dhe të heqë të tjerat, pasi ai e di se disa kompetenca kyçe janë zhvilluar, në një masë të caktuar, në këtë kapitull - për shembull, analiza, përdorimi reflektiv i mediave dhe përgjegjësia.
- Matrica ndihmon mësuesit për të përdorur pasojat sinergjike që ndihmojnë nxënësit të jenë të trajnuar në kompetencat e rëndësishme në mënyrë të përsëritur, në kontekste të ndryshme, të ndërlidhura në shumë mënyra. Në këtë rast mësuesi zgjedh dhe kombinon disa njësi.

Kapitujt	Dimensionet e zhvillimit të kompetencave			Qëndrimet dhe vlerat
	Analiza dhe gjykimi politik	Metodat dhe aftësitë	Vendimmarrja dhe veprimi politik	
8 Liria	Identifikimi i deklaratave kyçe Lidhja dhe renditja e argumenteve; bërja e një zgjedhje Analiza e ndërtimit selektiv të realitetit nga mediat	Debati: bërja e deklaratave të shkurtra dhe të qarta. Loja në ekip Shkrimi i një historie lajmesh	Marrja e një vendimi me shumicë votash	Etika e njohjes reciproke
2 Përgjegjësia				
7 Barazia	Analiza dhe zgjidhja e problemit shumicë/pakicë			Përgjegjësia është edhe më e rëndësishme se rregullat për ta bërë demokracinë funksionale (kapitujt 2 dhe 7)
5 Rregullat dhe ligji			Neutralizimi i mundësisë së konfliktit të përhershëm të interesave, duke projektuar një kuadër ligjesh dhe rregullash	
6 Qeveria dhe politika	Studim i debateve për hartimin e axhendës dhe vendimmarrjen		Identifikimi se ku mund të ndërhyjnë qytetarët në proceset e	

	politike		vendimmarrjes politike	
9. Media	Analiza e ndërtimit përzgjedhës të realitetit nga ana e mediave	Shkrimi i një historie të re	Përdorimi reflektiv i informacionit të transmetuar nga mediat	

KAPITULLI 8: Liria – debati në publik

Pse nuk liria (e fjalës) nuk vepron pa rregulla të ngurta?

Tema e mësimit	Trajnimi i kompetencave /objektivat e të mësuarit	Detyrat e nxënësve	Materialet dhe burimet	Metoda
Mësimi 1 Cilat çështje janë me interes për ne? (3 javë më parë)	Marrja e përgjegjësive. Kriteret për përzgjedhjen e çështjeve për një debat në klasë: rëndësia politike, interesat e nxënësve, lidhjet me kuptimin dhe përvojën e nxënësit.	Nxënësit japin ide dhe mbledhin informacion për çështje për debat.	Fletët e punës së nxënësit 8.1. Informacione përmes mediave. Të dhënat e përvojës personale dhe gjetjet. Tabela.	Puna në ekupe dyshe.
Mësimi 2 Përgatitja për debat	Pjesëmarrja: nxënësit bëjnë një zgjedhje me votim. Metodat dhe aftësitë: puna në ekip.	Nxënësit përgatisin rolet e tyre për debat.	Fletët e punës së nxënësit 8,2-8,5, 9.1. Debat. Punë në grup (votim).	Puna në grup, të mësuarit bashkëpunues.
Mësimi 3 Ne debatojmë - ne vendosim - ne raportojmë	E folura lirisht; argumentimi me një kundërshtar; bashkëpunimi në ekip. Respektimi dhe vlerësimi në shkëmbimin e argumenteve.	Nxënësit marrin pjesë ose shikojnë dhe dëgjojnë një debat. Detyrat që vijojnë për përgatitjen e mësimit të reflektimit.	Fletët e punës së nxënësit 8,2-8,5, 9.1.	Debat Punë në grup (votim). Shpjegimi.
Mësimi 4 Një debat - këndvështrimev të ndryshme	Identifikimi, balancimi dhe përzgjedhja e kriterëve sipas përparësive për një vendim. Kriteret kyç për zgjedhjen e një punë janë, "Cila punë i korrespondon interesave dhe pikave të mia të forta?"	Nxënësit krahasojnë lajmet në debat. Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre debatues.	Lajmet e shkruara nga nxënësit. Materiale për mësuesit 9.1.	Prezantime. Diskutim.

Mësimi 1

Cilat janë çështjet që na interesojnë?

Nxënësit marrin pjesë në planifikimin e debatit

Ju lutemi vini re: ky mësim zhvillohet tre javë para të tjerëve

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësues.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Marrja e përgjegjësisë; zgjedhja e artikujve dhe materialeve duke aplikuar një sërë kriteresh.
Objektivat e të mësuarit	Kriteret për përzgjedhjen e çështjeve për debat në klasë: afërsia politike, interesat e studentëve, lidhja me të kuptuarit dhe përvojën e nxënësve.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit japin ide dhe mbledhin informacion për çështjet për debat.
Materialet dhe burimet	Informacionet përmes mediave. Të dhënat e përvojës personale dhe gjetjet. Tabelë në mur për të shfaqur sugjerimet e nxënësve, me listë (emrat e nxënësve me një kuti në krah). Fleta e punës së nxënësit 8.1.
Metoda	Puna në ekipe në dyshe.
Koha në dispozicion	Përfshirja e nxënësve. 15 min
	Prezantimi i detyrës. 10 min
	Puna në ekipe në varg. 15 min
	Intervali mes mësimeve 1 dhe 2. 3 javë

Informacion për mësuesin: përse ky mësim zhvillohet tri javë më parë

Ky mësim zhvillohet tri javë përpara të tjerëve, për të mundësuar që nxënësit të përgatisin një informacion për mësimin e dytë dhe për të marrë pjesë në planifikimin e debatit në mësimin 3. Ky mësim shërben si një **organizator paraprak**: nxënësit marrin informacionin që u nevojitet paraprakisht.

Pjesëmarrja në planifikimin e mësimeve i përgjigjet pjesëmarrjes në komunitet. Në të gjitha rastet, qytetari aktiv është qytetari i informuar. I parë nga ky këndvështrim, organizatori, paraprakisht në këtë kapitull, demonstroi një parim të përgjithshëm të pjesëmarrjes në demokraci.


Organizimi paraprak kërkon një hapësirë kohe prej rreth tre javësh ndërmjet mësimit të parë dhe të dytë. (Mësuesi duhet të vendosë se si t'i përdorë mësime brenda këtij intervali.) Organizimi paraprak përbëhet nga dy faza:

Faza 1 (dy javë): nxënësit punojnë në ekipe dyshe. Në fund të fazës së parë, ekipet përpunojnë një sugjerim për një çështje të debatit që ata mendojnë se është interesante dhe e përshtatshme. Ata ofrojnë materiale informative për klasën (një faqe).

Një afat përcakton datën kur përfundon faza 1 dhe fillon faza 2.

Faza 2 (një javë): kohë leximi. Në fund të fazës 2, çdo nxënës duhet të jetë i familjarizuar me të gjitha çështjet e sugjeruara dhe të ketë lexuar të gjitha materialet. Çdo nxënës ka zgjedhur një çështje për debat.

Struktura kohore për organizimin paraprak

Mësimet	Mësimi 1		Mësimi 2
Veprimtaritë e nxënësve	Faza 1 Nxënësit përpunojnë sugjerimin e tyre për një çështje debatimi.		Faza 2 Nxënësit lexojnë propozimet Klasa zgjedh një çështje me votim
Linja e kohës	Jave 1	Java 2	Java 3
Afati 			

Përshkrimi i mësimit

Përgatitjet para mësimit

Për hapin 1, linja e debatit: nëse është e nevojshme, mësuesi hap klasën për ushtrimin e debatit.

Për hapin 2.3, udhëzimet për detyrën: mësuesi ka bashkangjitur dy fletë tabele në murin e klasës.

1. Përfshirja e nxënësve

Përgatitja: Mësuesi shënon një vijë në dyshe me një copë spango rreth pesë metra të gjatë. Nxënësit duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme për të qenë në gjendje të qëndrojnë në të dyja anët e kësaj vije, përballë njëri-tjetrit. Nëse klasa është shumë e vogël ose shumë e populluar, ky ushtrim mund të bëhet në korridor.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të ngrihen dhe të formojnë një rreth rreth vijës. Pastaj mësuesi shpall:

"Çdo fëmijë duhet bëjë edhe një vit shtesë në shkollë."

Mësuesi kërkon që nxënësit të lëvizin në një anë të vijës - në të majtë, në qoftë se ata e mbështesin deklaratën, në të djathtë, nëse nuk pajtohen. Ata kalojnë disa minuta për ndarjen e arsyeve dhe ideve të tyre.

Pastaj mësuesi kërkon që grupet të shkëmbejnë argumentet e tyre. Ka disa rregulla që duhet të respektohen:

1. Të dy palët mbajnë radhë në paraqitjen e argumentave.
2. Folësit nuk duhet të ndërpriten.
3. Folësit kanë 30 sekonda për të folur për pikën e tyre.

Nxënësit, më pas, angazhohen në një shkëmbim të argumenteve që i ngjan një debati. Pas pesë minutash, ose më herët, nëse njëra palë i ka shteruar idetë, mësuesi e ndal debatin dhe kërkon që nxënësit të kthehen në vendet e tyre – më e mira kërkon që veprimtaria të zhvillohet në një shesh të hapur për të lehtësuar dhe mbështetur komunikimin.

2. Prezantimi i detyrës

2.1 Pse është i rëndësishëm debati për pjesëmarrjen në demokraci

Mësuesi i referohet aktivitetit të mëparshëm - ai ishte një debat. Brenda një kohe të shkurtër, u shkëmbyen shumë ide dhe argumente. Nxënësit mund të komentojnë për përvojën e tyre.

Mësuesi shpjegon se nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre të debatit, sepse shumë diskutime në mjediset demokratike kryhen në këtë mënyrë. Shtetasit gëzojnë të drejtat e mendimit dhe shprehjes, por ata duhet të kenë aftësi debati për t'i ushtruar ato.

Mësuesi sigurohet që nxënësit e kuptojnë dhe pranojnë këtë përkufizim të detyrës së tyre të trajnimit.

2.2 Sqarim: çfarë e bën një çështje të mirë për debat?

Mësuesi i referohet temës - cila çështje është e mirë për debat? Çfarë e bën një çështje të mirë për debat?

Mësuesi dëgjon idetë dhe sugjerimet e studentëve dhe i përmbledh ato në fjalët kyçe në dërrasën e zezë ose në tabelë. Mund të pritët që ato, në një masë të madhe, të korrespondojnë me pesë kriteret (3a-3E) në Fletën e punës së nxënësit 8.1.

Mësuesi shpjegon se debati i ardhshëm do të jetë më interesant dhe nxënësit do të jenë më të suksesshëm nëse e zhvillojnë debatin për një çështje që e zgjedhin vetë. Ata do të kenë mundësinë për

të zgjedhur një çështje në mësimin tjetër pas tre javësh. Deri atëherë, ata duhet të zhvillojnë sugjerimet për çështje e debatit që duhet të mbahet atëherë. Klasa do ta bëjë një zgjedhje në mësimin e dytë.

Mësuesi shpërndan fletën e punës së nxënësit 8.1 dhe i referohet kritereve që nxënësit kanë sugjeruar dhe u kërkon atyre t'i krahasojnë ato me kriteret 3a-3e në broshurë. Nëse nxënësit dhe mësuesi bien dakord për të modifikuar listën e kritereve, ata e bëjnë këtë.

2.3 Udhëzime për detyrën: mbledhja e ideve në tabelë

Mësuesi shkon te tabela në mur dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë dhe Fletën e punës së nxënësit 8.1, ndërsa ai vizaton tabelën e mëposhtme:

Cila çështje është e mirë për debat?			
Jeta e përditshme ose në shkollë	Çështje kulturore ose sociale	Çështjet Politike	Çështje të tjera

Pasi nxënësit të kenë lexuar materialin, mësuesi i kthehet tabelës. Çështja që nxënësit diskutuan në fillim të mësimin ishte një çështje politike –“Si duhet të organizohet arsimit në vendin tonë?. Por çështje të tjera me shumë interes janë edhe:

- Çështjet politike
- Çështjet sociale
- Çështjet në shkollë ose në jetën e përditshme
- Çështjet e tjera - për të gjitha idetë e tjera.

Nxënësit mund të bazohen në përvojë e tyre personale, në atë çfarë dinë për agjendën aktuale politike ose mund të kërkojnë informacion shtesë.

Në këtë pikë, nxënësit duhet të kenë disa shembuj. Mësuesi i nxit ata të dalin përpara klasës me idetë e tyre. Nëse kjo është shumë e vështirë, mësuesi mund të ndihmojë me këto shembuj:

- *Jeta e përditshme ose në shkollë:* "Makina bën më shumë dëm sesa të mira."
- *Çështjet sociale ose kulturore:* "Televizioni luan një rol pozitiv në shoqëri." (Ose: interneti, telefonat celular etj.)
- *Çështjet politike:* "Gratë duhet të trajtohet njësoj si burrat."

2.4 Udhëzime për detyrën: respektimi i afatit

Së fundi, mësuesi shpjegon pse ka një afat. Për t'i dhënë të gjithëve mundësinë për të lexuar materialet, vihet një afat - pesë ditët shkolle para zhvillimit të mësimin të parë. Nxënësit duhet të kuptojnë se ata do të zgjedhin një çështje, por ata duhet t'i kenë lexuar materialet paraprakisht. Përndryshe, nuk mund të zhvillohet një votim demokratik, pasi ai duhet të organizohet në mënyrë efikase brenda kohës në dispozicion. Gjatë mësimin nuk do të ketë kohë për të lexuar materialet. Mësuesi u tregon nxënësve se ku duhet t'i depozitojnë fletën e shënimeve dhe materialet. Së fundi ai thekson se është e rëndësishme për nxënësit për të vendosur se për cilën çështje do të donin të zhvillohej debati.

3. Puna në ekipe në varg

Nxënësit formojnë ekipe së bashku dhe punojnë më vete, duke ndjekur udhëzimet e dhëna në broshurë dhe gjatë mësimin. Ata i caktojnë vetë detyrat e shtëpisë.

Mësimi 2

Përgatitja për debatin

Deklaratat kryesore dhe strategjitë e debatit

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësues.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Pjesëmarrja: nxënësit bëjnë një zgjedhje me votim. Metodatat dhe aftësitë: puna e ekipit.	
Objektivat e të mësuarit		
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përgatisin rolet e tyre për debat.	
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 8.2-8.5, 9.1. Informacion i medias. Një tabloid dhe gazetë cilësore, një revistë për të rinjtë.	
Metoda	Puna në grup, të mësuarit bashkëpunues.	
Koha në dispozicion	1. Nxënësit zgjedhin një çështje.	10 min
	2. Krijimi i grupeve për debat.	10 min
	3. Puna në grup.	20 min

Informacion

Kapitulli përbëhet nga dy aktivitete: 1. nxënësit zgjedhin çështjen e debatit dhe 2. nxënësit formojnë grupe dhe përgatitin debatin në rolet e tyre të ndryshme: të dy ekipet në debat (ai "pozitiv" ose në anën pro dhe ai "negativ" ose pala kundër).

Pjesa kryesore e mësimit duhet të shpenzohet për përgatitjen e debatit. Prandaj është e rëndësishme të kryet një votim normalisht dhe me efikasitet.

Për grupet e gazetarisë së lajmeve, është një përvojë emocionuese të shohin historinë e tyre të botuar nga një gazetë të vërtetë. Mësuesi mund t'ia sugjerojnë këtë ide ekipit të gazetarëve të lajmeve. Nëse nxënësit janë dakort, mësuesi vendos me ta si t'i drejtohen një gazete.

1. Nxënësit përzgjedhin një çështje

Mësuesi vepron si kryesues në këtë seancë të parë të mësimit. Së pari ai falënderon nxënësit për prodhimin e kaq shumë ideve interesante. Më tej ai shpjegon procedurën.

Nga nxënësit pritet që të kenë lexuar idetë dhe materialet e prodhuara nga shokët e tyre dhe që të kenë vendosur se cilat çështje do të donin të debatoheshin. Procedura e votimit mund të zhvillohet nga dy nxënës. Njëri nga nxënësit pyet të tjerët për preferencën e tyre. I dyti shënon temat në një listë në dërrasë, duke nënvizuar ato që janë përzgjedhur disa herë.

Pastaj temat renditen dhe, me shumicë votash, klasa bën një zgjedhje në mes të tre të parave në krye të listës së klasifikimeve. Tema zgjedhur bëhet çështja e debatit.

2. Krijimi i grupeve për debat

Mësuesi fton nxënësit në debat. Një debat vijon me rregulla të caktuara. Nxënësit formojnë grupe dhe ekipe që kryejnë role të ndryshme.

Nxënësit kanë marrë Fletën e punës së nxënësit 8.2 dhe lexojnë në heshtje. Ata bëjnë pyetje për të sqaruar çdo gjë të nevojshme dhe (mundësisht) nxënësit e tjerë ose mësuesi i japin përgjigje. Nxënësit duhet të kuptojnë se çfarë roli kryejnë ekipet e ndryshme.

Nxënësit bashkohen me një nga ekipet e mëposhtme. Kjo tabelë tregon se çfarë grupesh marrin pjesë në debat dhe çfarë flete pune u nevojitet atyre. Ekipet debatuese duhet të ketë një anëtar rezervë, në rast një anëtar i ekipit është i sëmurë në ditën e debatit.

Të dy kryetarët ndajnë detyrat e kryerjes së debatit dhe të votimit të publikut. Nëse një kryetar është i sëmurë, tjetri merr përsipër të dy pjesët.

Grupi	Numri i anëtarëve (+ anëtarë rezervë)	Fletët e punës së nxënësit Nr.
Ekipi i debatit nr 1 ("pozitiv")	5 (+1)	8.3
Ekipi i debatit nr 2 ("negativ")	5 (+1)	8.3
Kryetari i parë dhe i dytë	<u>2</u>	8.2, 8.4, 8.5
Ekipet e reporterëve (gazetë cilësore, gazetë tabloid, revista rinore)	3 x 2	8.6, 9.1
Audienca	Të gjithë nxënësit e mbetur	8.5

Kjo mund të bëhet më e përshtatshme duke krijuar kolona në dërrasën e zezë ose në dyshe te tabela. Nxënësit shkruajnë emrat e tyre në grupin e zgjedhur. Nëse një grup është i tejmbushur, mësuesi dhe klasa vendosin së bashku se si të zgjidhin problemin. Ai është problemi i tyre, jo i mësuesit. Përvoja ka treguar se nxënësit janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe grupet formohen shpejt, me një rezultat të kënaqshëm për nxënësit.

3. Përgatitjet për debat

Grupet marrin kopje të Fletëve të punës së nxënësit 8.3 (ekipe debatuese), 8.4 (audienca) ose 8.5 (ekipi i gazetarisë). Grupet shpenzojnë gjysmën e dytë të orës duke planifikuar aktivitetin e tyre të mësimin dhe, nëse është e nevojshme, mund t'i caktojnë vetes një pjesë të detyrave të shtëpisë. Mësuesi vepron si vëzhgues dhe trajner. Si trajner, mësuesi nuk u afrohet grupeve, nuk lexon letrat e tyre, as edhe nuk i ndihmon ata në prodhimin e rezultateve. Nëse grupet kanë nevojë për ndonjë mbështetje, ata i afrohen mësuesit. Nëse jo, ata janë të lirë dhe përgjegjës për të punuar si e mendojnë të drejtë. Përvoja ka treguar se nxënësit vlerësojmë besimin që është vendosur për ta, i cili vepron si një nxitje e fortë.

Mësuesi u jep gazetarëve të lajmeve një kopje të llojit të gazetës së tyre - letër tabloid, gazetë cilësore ose revistë rinore. Kjo do t'i ndihmojë ata të imagjinojnë se çfarë lloj profili dhe audience leximi ka gazeta e tyre dhe si duhet të jetë historia e lajmit të tyre.

Nëse është e mundur, mësuesi u kërkon nxënësve që të vendosin tavolinat dhe karriget për debat përpara se të fillojë mësimi, siç tregohet në materialet e Fletës së punës së nxënësit 8.2.

Mësimi 3

Ne debatojmë - ne vendosim - ne raportojmë

Debati dhe vendimmarrja në publik

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Të folurit lirisht; argumentimi me një kundërshtar; bashkëpunimi në një ekip. Respektimi dhe vlerësimi në shkëmbimin e argumenteve.
Objektivat e të mësuarit	Në lidhje me temën që diskutohet.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit marrin pjesë në të, shikojnë dhe dëgjojnë një debat. Detyrat që ndjekin për grupet që të përgatiten për mësimin e reflektimit.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 8.2-8.5, 9.1.
Metoda	Debat, puna në grup (votimi), sqarim.
Koha në dispozicion	1. Debat. 25 min
	2. Votimi i publikut. 10 min
	3. Detyrat e shtëpisë: të dhënat për reflektim. 5 min

Informacion

Ky mësim përfshin detyrën kryesore të të gjithë kapitullit - debatin. Përgatitja e gjerë në mësimin e mëparshëm kishte për qëllim t'u jepte nxënësve besimin për të vepruar në rolet e tyre.

Kryesuesit janë përgjegjës për menaxhimin e debatit dhe votimin e publikut.

Mësuesi hap dhe përfundon mësimin dhe, kryesisht, vepron si vëzhgues.

Fletët e punës së nxënësit japin rregullat dhe udhëzimet për grupet – si të kryejnë rolet e tyre. Kjo vendosje është tipike për të mësuarit e bazuar në detyra: mësimi është shumë i strukturuar përmes detyrave të ndryshme dhe i kornizuar nga rregullat dhe orari, ndërsa mësuesi pothuajse nuk e merr kurrë fjalën. Por megjithatë, objektivat e mësimit që mësuesi ka në mendje janë të pranishëm gjatë gjithë mësimit, madje edhe më shumë se në udhëzimet frontale, sepse tani, janë nxënësit që e kanë marrë në do të atë.

Përshkrimi i mësimit

Fleta e punës së nxënësit 8.4 (roli i kryesuesit) jep një përshkrim të detajuar për zhvillimin e debatit dhe votimin e publikut. Prandaj, përshkrimi i këtyre fazave mund të jetë shumë i shkurtër.

1. Debati

Mësuesi shpall agjendën e mësimit: debati, i ndjekur nga vota e publikut dhe një përmbledhje. Nëse është e nevojshme, mësuesi u kërkon nxënësve të rregullojnë tavolinat dhe karriget në mënyrë se si do vendosen siç tregohet në Fletën e punës së nxënësit 8.2.

Pastaj kryetari i parë fillon. Nxënësit zënë vendet e tyre, si ekipe debatimi, kryetar, audiencia dhe gazetarët e shtypit. Mësuesi zë vend në audiencë, mundësisht në rreshtat prapa. Nxënësit nuk duhet të kërkojnë të vendosin kontakt me sy me mësuesin, por me njëri-tjetrin. Ata kryejnë rolet e tyre dhe mësuesi dëgjon.

2. Votimi i publikut

Kryesuesi i dytë drejton diskutimin e publikut dhe votimin. Këtu, mësuesi largohet nga audiencia dhe i vëren nxënësit nga distanca. Ndërsa nxënësit e audiencës diskutojnë për votimin e tyre, ekipet e debatimit dhe reporterët e lajmeve dëgjojnë.

Pas pesë minutash, kryetari përfundon diskutimin dhe zhvillon votimin. Pasi kryesuesi e ka përfunduar votimin, mësuesi merr drejtimin.

3. Detyrat e shtëpisë: të dhënat për mësimin në vijim (mësimi 4)

Mësuesi falënderon kryetarët për menaxhimin e pjesës kryesore të mësimit. Më pas ai falënderon nxënësit dhe audiencën dhe vlerëson si e mendon të përshtatshme. Nuk ka komente kritike në këtë pikë. Mësimi i katërt jep mundësi për të dhënë komente dhe për të reflektuar për mësimin e debatit dhe votimit, dhe kjo është ajo që ai u tregon nxënësve.

Ai u kërkon të gjithë nxënësve, me përjashtim të gazetarëve të lajmeve, që të mendojnë për ndjenjat e tyre, përshtypjet dhe pikëpamjet për seancën e debatit, diskutimit pasues dhe votimit, të përgatitin një deklaratë të shkurtër si informacion për mësimin e ardhshëm, duke trajtuar çështjet kyçe në vijim:

1. Jepni mendimin tuaj në lidhje me çështjen në shqyrtim. Shpjegoni se çfarë argumenti ju ka bindur më shumë në formimin e mendimit tuaj.
2. Nga këndvështrimi juaj, përshkruani çfarë i ndikon rregullat dhe cili ishte ndikimi në debat i afatit prej një minute.

Ekipet e reporterëve të shtypit nuk duhet kenë detyrë tjetër përveç prodhimit të historisë së tyre të lajmeve. Mësuesi thërret gjashtë nxënësit, që të vendosin se si do të shpërndahen lajmet – duke paraqitur dy ose tri kopje në mur apo duke dhënë një fletë pune për çdo nxënës.

Mësimi 4

Një debat – këndvështrime të ndryshme

Nxënësit reflektojnë për debatin

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Analiza dhe gjykimi i një përvojë të përbashkët.	
Objektivat e të mësuarit	Mediat ndërtojnë perceptimin tonë të realitetit. Rregullat sigurojnë mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtat e lirisë.	
Detyrat e nxënësve	Nxënësit krahasojnë historitë e lajmeve në debat. Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre në debat.	
Materialet dhe burimet	Lajme të shkruara nga nxënësit. Materiale për mësuesit 9.1	
Metoda	Prezantime. Diskutim.	
Koha në dispozicion	1. Tre raportime lajmesh me diskutim.	15 min
	2. Reflektim: si ndikuan rregullat në debat?	15 min
	3. Shpjegimi.	10 min

Informacion

Nxënësit reflektojnë për mësimin nga dy plane, në atë të përmbajtjes dhe në atë të kuadrit të rregullave. Nxënësit mund të jenë më të interesuar në një aspekt se sa në tjetrin dhe fokusi mund të zhvendoset në përputhje me rrethanat, duke i dhënë më shumë kohë një teme.

Shpjegimi u jep nxënësve mundësinë për disa komente të përgjithshme për kapitullin.

Nxënësit janë përgatitur për të dhënë kontribut gjatë mësimit. Prandaj, mësuesi mund dhe duhet t'u japë nxënësve një pjesë të madhe të kohës për të folur. Ndërhyrjet e nxënësve pritet të zgjasin për të gjithë orën e mësimit (shih pyetjet kryesore për të dhënat e nxënësve). Mësuesi kryeson mësimin dhe jep të dhëna të shkurtra për të përmbledhur dhe stukturuar diskutimet.

Përshkrimi i mësimit

Qartësimi i agjendës për mësimit

Mësuesi paraqet agjendën e mësimit dhe thekson se ajo i korrespondon pyetjeve kryesore të detyrave të shtëpisë të nxënësve. Nëse nxënësit janë dakord dhe nuk bëjnë asnjë sugjerim për t'u përqëndruar në një pikë të veçantë, mësuesi paraqet fazën e parë të mësimit.

1. Tre raportet e lajmeve me diskutim

Mësuesi njofton se tre ekipet e reporterëve do të paraqesin tregimet e tyre të lajmeve. Nxënësit kanë për detyrë të dëgjojnë dhe të krahasojnë, sepse gazetarët punojnë për lloje të ndryshme gazetash. Për të krahasuar lajmet, nxënësit duhet të jenë gati të marrin shënime. Mësuesi sqaron detyrën duke vizatuar një matricë të thjeshtë në dërrasë ose në tabelë:

Historia e lajmit	Nr . 1	Nr. 2	Nr.3
Gjuha			
...			
...			
...			
Vendimi			

Mësuesi i referohet gazetës vetëm nga numri, duke ia lënë nxënësve për të paraqitur gazetën e tyre. Gjuha është një tipar i mundshëm nga e cila mund të krahasohen tregimet dhe nxënësit janë të lirë të marrin shënime çfarë shohin. Nëse ata preferojnë një lloj gazete dhe lajmet në të, ata duhet të japin arsyet.

Mësuesi sigurohet që nxënësit nuk kanë më pyetje për detyrat e tyre dhe pastaj i jep fjalën tre ekipeve të raportuesve për shtyp. Ekipet e raportuesve për shtyp lexojnë tregimet e tyre me radhë, pa asnjë diskutim apo koment ndërmjet tregimeve.

Pastaj nxënësit japin komentet. Mësuesi dëgjon dhe inkurajon nxënësit të shpjegojnë se çfarë kriteresh përdorën për të krahasuar dhe gjykuar tregimet.

Mësuesi përmbledh diskutimin duke vënë në dukje një aspekt të rëndësishëm: të tre ekipet e gazetarëve të shtypit ndoqën të njëjtin debat dhe imazhet që ata krijuan për audiencat e tyre të leximit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Kjo tregon se media e transmeton realitetin për të gjithë ata që nuk ishin të pranishëm në këtë ngjarje. Por, duke e transmetuar realitetin, ata e ndërtojnë atë – duke zgjedhur dhe duke theksuar disa elemente, duke lënë jashtë ose duke i kushtuar më pak vëmendje të tjerëve. Mësuesi mund t'i referohet detajeve të përzgjedhura të lajmeve apo reagimeve të nxënësve për të mbështetur këtë pikë (shih Materiale për mësuesit 9.1).

2. Reflektim: si e ndikuan rregullat debatin?

Mësuesi përsëri kërkon reagimet e nxënësve. Mësuesi dëgjon dhe kështu bëjnë nxënësit. Disa komente pritet të jetë mjaft kritike (afati kohor është "jodemokratik", ai nuk lejoi shprehjen e lirë) dhe disa nxënës mund ta mbështesin këtë.

Gjatë diskutimit, mësuesi mund të kërkojë nga kritikët në mesin e nxënësve që të marrin parasysh se çfarë do të ndodhte në qoftë se hiqet afati. Ata do të kuptojnë se debati do të ketë nevojë për kohë më të gjatë, dhe kohëzgjatja e mësimit na vendos një limit absolut kohor, dhe për këtë arsye, rregullat marrin parasysh realitetin dhe shpërndajnë kohën në dispozicion të tyre në mënyrë të drejtë, nëse është e mundur, në periudha shumë të vogla. Folësit duhet komentojnë se si ata e përballuan afatin kohor: a ia dolën ata të përqendroheshin në pikat kyçe?

3. Përmbledhje

Këtu nxënësit japin disa vlerësime të përgjithshme.

Mësuesi nuk duhet të përpiqet të justifikojë punën e tij përballë kritikës dhe as të argumentojë largimin e vërejtjeve kritike. Meqenëse nxënësit kanë pasur për vete një pjesë shumë të madhe të veprimtarisë dhe përgjegjësisë, si sukcesi dhe dështimi janë më shumë të tyre se sa të mësuesit. Mësuesi duhet ta theksojë këtë, në qoftë se nxënësit nuk janë të vetëdijshëm.

Nëse nxënësit kënaqen me debatin, mësuesi mund të sugjerojë shtrirje në formën e një klubi debatesh. Këtu mund të debatohen disa nga çështjet e propozuara nga vetë nxënësit. Klubet e debatit janë shumë të zakonshme në vendet ku flitet anglisht në mbarë botën, dhe po ashtu në mesin e mësuesve të gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Interneti ofron një shumëllojshmëri të pasur të materialit të shkëlqyer për mësuesit dhe nxënësit e interesuar në debatim.

Materialet për mësuesit 8.1

Pse liria varet nga kuadri i rregullave dhe ligjeve

Mundësitë e mësimit në këtë kapitull

Ndërvarësia përmes mungesës së kohës

Burimi më i çmuar i mësimdhënies dhe të mësuarit, dhe në jetën tonë në përgjithësi, është koha. Si profesionist, mësuesi duhet vazhdimisht t'i përgjigjet pyetjeve se si koha në dispozicion në klasë mund të përdoret sa më mirë që të mundet, dhe si, në të mësuarit ndërveprues, nxënësit marrin përgjegjësi për këtë. Organizatori paraprak në këtë kapitull do të veprojë vetëm në qoftë se nxënësit pranojnë përgjegjësinë e tyre për të përdorur kohën për të lexuar materialet e njëri-tjetrit (kur ai është në dispozicion) përpara mësimit të parë. Në mësimin e parë, katër grupeve, mund t'u jepet jo më shumë se 10 minuta për të zgjedhur një çështje për debat. Në qoftë se ata dështojnë për të lexuar materialet paraprakisht, klasa do të ketë një ide të mirë më pak në dispozicion për të zgjedhur – dhe ky është një shembull i varësisë sonë nga njeri-tjetri (ndërvarësia).

Rregullat e ngurta për të mbrojtur lirinë e fjalës

Një debat duhet të zhvillohet brenda kohës së caktuar. Të gjithë folësit gëzojnë të njëjtat të drejta të mendimit dhe të shprehjes së lirë. Prandaj, koha në dispozicion për të folur duhet të shpërndahet në mënyrë të drejtë, që do të thotë barazi, një minutë për çdo deklaratë. Duket paradoksale që rregullat e ngurta janë të nevojshme dhe të dobishme për të mbrojtur lirinë tonë. Afati vepron në dy mënyra: pjesa jonë e kohës për të folur garantohet dhe ajo është e drejtë. Nga ana tjetër, ajo kufizon çdo folës në një kohë të caktuar të shkurtër, dhe folësit duhet të mendojnë me kujdes për atë që duan të thonë. Ata duhet të përqendrohen në argumentet kryesore, të lënë mënjanë çdo gjë me më pak rëndësi dhe të bëjnë të njohur idenë kryesore qartë dhe shkurtimisht.

Liria dhe kufizimi

Liria e nxënësve në veprime dhe fjalë është e kornizuar ose e kufizuar dhe e përcaktuar në dy mënyra. Së pari, nga kohë e të mësuarit në dispozicion - mësimet mbarojnë pas 40 minutash dhe debati duhet të përshtatet në një mësim dhe të marrë jo më shumë se 20 minuta, sepse gjëra të tjera janë të nevojshme në po atë mësim. Së dyti, rregullat e debatit i japin çdo folësi një kohë të drejtë, por rreptësisht të kufizuar prej një minute për deklaratë. Kufizimi ka një dimension strukturor - koha është e kufizuar gjatë gjithë jetës sonë - një dimension politik i krijuar nga vetë njeriu: rregullat vendosin korniza, pa të cilat, ne nuk mund të gëzonim liritë tona pa dhunuar të drejtat e të tjerëve. Mungesa e kohës nuk është e negociueshme, por kufizimi me rregullat, po.

Shkolla është jeta

Dialektika e lirisë dhe kufizimit, e rrënjësuar në mungesën universale të kohës, ndodh në shkollë si edhe në jetën publike. Këtu, në një kuptim shumë të saktë, shkolla është jeta.

KAPITULLI 9

MEDIA

Arsimi i mesëm

Pjesëmarrja në demokraci përmes medias

<p>Në demokracitë pluraliste, grupet promovojnë qëllime, interesa dhe vlera të ndryshme (Qëllimet A dhe B). Secili grup argumenton qëllimet e saj (A1, A2, B1, B2), duke u përpjekur të ndikojë në vendimin përfundimtar në favor të tyre (AAB? – BBA?). Pluralizmi nxit konkurrencë dhe polemika. Media e lirë mbështet debatet e gjalla.</p>	<p>Në diktatura, grupe apo individë që promovojnë një alternativë ose që artikulojnë kritika bëhen të heshtin (simboli-X). E drejta për pjesëmarrje është dhënë vetëm për përkrahësit e regjimit. Mediat janë të censuruara. Sundimtari vendos çfarë problemesh, interesash apo qëllimesh pranohen në agjendën politike.</p>
<p>Polemika konsiderohet si e nevojshme dhe produktive për të arritur marrëveshje dhe kompromis. Vendimet janë të hapura për shqyrtim kritik.</p>	<p>Pëlqimi zbatohet dhe paracaktohet nga drejtuesi. Kontradiktat konsiderohet pa harmoni dhe të rrezikshme, pasi është e vështirë t'i kontrollosh.</p>

Fleta e punës për nxënësit 3.6


Harta e ndarjeve shoqërore dhe partitë politike



Çdo shoqëri ka disa yllësi themelore të konfliktit, të quajtura **ndasitë**. Ndasitë në mes të Majtës-Djathtës ndodhin në të gjitha vendet me sisteme kapitaliste të tregtisë së lirë. Kjo çarje daton në revolucionin industrial në shekullin e 19. Dy ndasitë e tjera janë më të fundit. Ndasia mes mjedisit kundrejt rritjes ekonomike u shfaq në axhendë në vitet 1970. "Shtet i fortë" përkundrejt të drejtave civile u riaktivizua në luftën kundër terrorizmit pas 11 shtatorit 2001. Sistemi i partive politike përshkruan këto ndasi. Ata përfaqësojnë interesat e grupit dhe i japin përparësi ndasive të caktuara. Çdo shoqëri ka strukturën e saj të veçantë të ndasive. Sa më shumë ndasi të ketë një shoqëri, aq më e vështirë është për t'u qeverisur.

Fleta e punës për nxënësit 4.1

Studim rasti: konflikti në komunitetin e peshkimit



I. Komuniteti peshkimit

Imagjinoni një liqen të madh plot me peshq. Në brigje, peshkatarët jetojnë në katër fshatra të vegjël - komunitete peshkimi. Çdo fshat dërgon një ekuipazh për të kapur peshk. Në sezonin e fundit, peshkatarët i lejojnë rezervat e peshkut të rinovohen, ndërkohë që riparojnë rrjetat dhe anijet e tyre. Ata nuk kanë asgjë tjetër për të jetuar përveç peshkut. Atë që nuk e hanë me familjet e tyre, ata mund ta shesin në një treg afër. Me këto të ardhura, peshkatarët ushqehen, vishen dhe strehojnë veten dhe familjet. Standardi i tyre i jetesës është modest, por i mjaftueshëm.

II. Konflikti rreth keqpërdorimit të burimeve

Në dy-tre vitet e fundit, një konflikti serioze ka shpërthyer në komunitetin e peshkimit. Disa ekipe peshkimi janë përpjekur që të rritin të ardhurat e tyre duke kapur më shumë peshk. Tani shifrat e riprodhimit kanë rënë, dhe rezervat e peshkut kanë rënë përgjysmë në tre vjet. Komuniteti i peshkimit përballet me një seri të tërë problemesh:

1. rënia e rezervave të peshkut, me rrezikun e zhdukjes totale;
2. ulja e prodhimit të përgjithshëm të peshkut;
3. hendeku mes dy fshatrave të pasur dhe dy fshatrave të varfër të peshkimit ("fitues dhe humbës");
4. rreziku i konfliktit të dhunshëm në mes të fshatrave të peshkimit.

Ky është një konflikt rreth keqpërdorimit të një burim të përbashkët. Kjo duket të jetë e bazuar në tri gjëra që përforcojnë njëra-tjetrën:

1. Ekziston një stimul që inkurajon peshkatarët për të kapur më shumë peshk;
2. Ka mungesë totale të rregullave, kështu që peshkatarët mund të bëjnë çfarë të duan;
3. Ekipet e peshkatarëve nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

III. Analiza e konfliktit ("diagnoza")

1. Nxitja për mbishfrytëzim të rezervave të peshkut

Çdo peshkatar e di se komuniteti mbështetet në rezervat e peshkut, dhe për këtë arsye është e ndjeshme për të lejuar rezervat e peshkut të rinovohen plotësisht.

Nga ana tjetër, çdo peshkatar gjithashtu e di se në qoftë se ekuipazhi i tij do të kapë një peshk më shumë, rezervat e peshkut ndoshta nuk do të vuajnë. Ajo do të bënte një ndryshim të të ardhurave të ekuipazhit, ndërsa shpenzimet - kujdesjen për rezervat e peshkut - do ta përballonte i gjithë komuniteti. Kjo shpërndarje e pabarabartë e fitimeve dhe kostove shtesë punon në të mirë të peshkatarëve që kapin më shumë peshk. Kjo është një nxitje për të peshkuar më shumë. Nga kënd vështrimi individual i peshkatarit, duket e arsyeshme që të kapet më shumë peshk.

<p>Të ardhura shtesë (+ 100%) Kosto shtesë -25%</p>	<p>Fitimi shtesë (+ 75%)</p>	<p>Të ardhurat dhe fitim total shtesë shkon për ekuipazhit nr 1.</p>	<p>Ekuipazhi 4 -25%</p>	<p>Të ardhura shtesë (+ 0%) Kosto shtesë (4x -25%)</p>
			<p>Ekuipazhi 3 -25%</p>	
	<p>Ekuipazhi 2 -25%</p>			
	<p>Ekuipazhi 1 -25%</p>			
<p>Kosto shtesë (-25%)</p>		<p>Ekuipazhi nr 1 me kapje ekstra</p>		
			<p>Komuniteti peshkimi (të katër ekipet)</p>	

Një ekuipazh kap më shumë peshk: shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave shtesë, kostove dhe fitimit shtesë për komunitetin e peshkimit.

Të gjithë peshkatarët janë të vetëdijshëm për këtë nxitje dhe janë plotësisht të informuar për pasojat e asaj që bën secili. Skenari më i keq ka gjasa të ndodhë - ata të gjithë bëjnë të njëjtën gjë, dhe kapin sa më shumë peshk që të mundën. Si rezultat, rezervat e peshkut janë mbishfrytëzuar dhe nuk mund të rinovohen më plotësisht. Një rreth vicioz ka filluar, sepse peshkatarët mund të kompensojnë humbjet e të ardhurave të tyre me një nivel edhe më të lartë mbipeshkimi.

2. Mungesa e rregullave

Peshkatarët veprojnë në këtë mënyrë, sepse nuk ka rregulla fare, nuk ka udhëzime, nuk ka siguri, nuk ka qëllime të komunitetit, nuk ka sanksione. Kështu si janë gjërat, çdo peshkatar mund të bëjë si të dojë dhe çdo gjë që ai e kap, i takon atij.

Në këto rrethana, sjellja e peshkatarëve nuk është për t'u habitur - pasojat në komunitet dhe rezervat e peshkut, nga ana tjetër, janë shkatërruese.

3 Mungesa e komunikimit

Deri më tani, peshkatarët nuk janë takuar dhe biseduar për gjendjen e tyre. Ata veprojnë si ta mendojnë më mirë, dhe reagojnë ndaj vendimeve të marra nga ekipet e tjera.

4. Efekti i keqmenaxhimit të burimeve


Modeli i qëndrueshmërisë na ndihmon për të përcaktuar dëmin e bërë nga keqadministrimi i peshkatarëve dhe mund të na ndihmojë për të përcaktuar një model të politikave alternative (shih Fletët e punës së nxënësit 4.2 dhe 4.4).

IV. Zgjidhja e konfliktit

"Diagnoza" e konfliktit duhet të merret në konsideratë kur zgjedhim "terapinë".

Fleta e punës për nxënësit 4.2

Një model i objektivave të qëndrueshme



Si ta lexojmë këtë diagramë

Modeli integron tre qëllime qëndrueshmërie dhe i vendos ato në dimensionin historik dhe global:

1. "Mjedisi": mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore;
2. "Ekonomia": Rritja ekonomike (produktiviteti, prodhimi, pasuria);
3. "Shoqëria": kohezioni social, shpërndarje e drejtë e mirëqenies;

Shigjetat dy kahëshe tregojnë se qëllimet mund të mbështetin ose të përjashtojnë **reciprokisht** njëri-tjetrin.

Fleta e punës për nxënësit 4.3

Zbatimi i modelit të qëndrueshmërisë për lojën e peshkimit: si mund të "kapim sa më shumë peshk që të jetë e mundur"?


Qëllimet e modelit të qëndrueshmërisë	Çfarë duhet të arrijmë në lojën e peshkimit
Ekonomi: Rritja ekonomike, rritja e mirëqenies	
Shoqëria: Shpërndarja e mallrave në komunitet	
Mjedisi: Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore	
Stabiliteti afatgjatë: Arritja e qëllimeve të qëndrueshmërisë sot dhe në të Ardhmen	
...	

Fleta e punës për nxënësit 4.4

Cila është balanca optimale midis riprodhimit të peshkut dhe sasisë së kapur?

Rezervat e peshkut prodhojnë sasi më të mëdha ose më të vogla të peshkut të ri, në varësi nga sasia e peshkut të mbetur në liqen pas mbarimit të sezonit të peshkimit. Cila është sasia e peshkut që jep sasinë më të madhe të peshkut të ri? Përgjigja për këtë pyetje jep çelësin për një peshkim të qëndrueshëm.

Rinovimi i sasisë së peshkut në ton



Rinovimi

Rezervat e peshkut në fund të sezonit në ton

Stok në fund të sezonit	Rinovimi (prodhimi i peshkut të ri)	Sasia stok në fillim të sezonit të ri
80	29	109
85	31	116
90	34	124
95	39	134
96	40	136
97	41	138
98	42	140
99	42	141
100	42	142
101	41	142
102	40	142
103	40	143
104	39	143
105	39	144
110	36	146
115	32	147
120	28	148

Kjo tabelë tregon **normat e pikut të rinovimit** që rezervat e peshkut janë të afta për të prodhuar. Këto norma janë ideale për peshkim të qëndrueshëm.

Fleta e punës për nxënësit 5.1

Përgatitjet për konferencën për një kuadër rregullash

Orari

Afati kohor	Agjenda	Materialet dhe burimet
Mësimi 1	Formimi i grupeve të punës. Secili grup përfshin një anëtar nga çdo fshat peshkimi.	Fletët e punës 5.1, 5.2.
Mësimi 1 Mësimi 2	Grupet hartojnë një kuadër të rregullave. Grupet përgatisin prezantimet e tyre. Anëtarët e komunitetit miratojnë rregullat e procedurës dhe votimit për konferencën.	Fletët e punës 5.2, 5.4. Tabelë dhe lapustila.
Mësimi 3	<i>Takim Plenar:</i> Grupet paraqesin projektet e tyre. Anëtarët e komunitetit krahasojnë dhe gjykojnë draft kuadrin e rregullave. Anëtarët e komunitetit diskutojnë për kuadrin që duhet të miratojnë.	Fletët e punës 5.3
Mësimi 4 Konferenca	<i>Konferenca:</i> Anëtarët e komunitetit mbajnë fjalim të shkurtër promovues për modelin e zgjedhur prej tyre. Ata miratojnë një kuadër rregullash me shumicë votash. Ata nënshkruajnë dokumentin kornizë origjinal. <i>Reflektim</i> Nxënësit reflektojnë për përvojat e tyre.	Fletët e punës 5.4 Fletë A4 e bardhë, stilolapsa, lapustila.

Pse duhet të luani lojën e vendimmarrjes?

Metoda e zbatuar në orarin e mësipërm është një lojë vendimmarrjeje. Arsyeja për zgjedhjen e kësaj metode është në vijim.

Loja punon si një model. Ajo paraqet aspekte të rëndësishme të realitetit. Ajo i tregon ato qartë, por duke lënë jashtë shumë detaje të tjera. Të gjitha vendet kanë një lloj kornize bazë, një kushtetutë që paraqet rregullat për marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e konflikteve. Pa një kuadër të tillë, anëtarët e një komuniteti nuk do të kenë mbështetje për zgjidhjen e konflikteve të tyre dhe për rrjedhojë mund t'i drejtohen dhunës.

Kur merrni pjesë në demokraci, ju ushtroni të drejtat që jua ka dhënë kushtetuta e vendit tuaj. Mënyra më e mirë për të kuptuar si vepron kuadri i rregullave dhe ligjeve në vendin tuaj, është të krijosh vetë një kuadër të tillë. Kjo lojë vendimmarrjeje ju vendos në këtë situatë.

Fleta e punës për nxënësit 5.2

Pyetje themelore që duhet të merren parasysh në projektimin institucional

Kur hartoni një kuadër rregullash, ju bëni disa zgjedhje bazë. Ju vendosni për modelin e qeverisjes (vendimmarrjes) që preferoni dhe për pronarin e peshqëve që janë kapur. Ju mund të krijoni kombinime të ndryshme me këto forma bazë dhe të arrini në zgjidhje shumë të ndryshme.

	Qeverisja	Hierarkia (autoritet shtetëror)	Rrjeti bashkëpunëtorëve
Prona			
Prona private			
Prona publike			

Seksionet e mëposhtme japin më shumë informacion për opsionet e ndryshme.

1. Zgjedhja e një modeli të qeverisjes

Agjenti kyç	Shteti	Rrjetet lokale
Konceptet kyç	Pushteti dhe autoriteti	Marrëdhëniet personale, komunikim dhe interesat e përbashkëta
Projekto parimet e kornizës	Hierarkia (kokë poshtë)	Partneriteti (në nivelin e syve)
Fuqitë	Paqja dhe Siguria Ligjet e lejojnë qartësisht ose ndalojnë se si sillen njerëzit Ligjet mund të zbatohen në se nuk thyen	Ekspertizë e lartë dhe fleksibilitet në zgjidhjen e problemeve dhe duke i shërbyer interesave të njerëzve Liria për të improvizuar dhe reaguar shpejt
Dobësitë dhe rreziqet	Rreziku i abuzimit me pushtetin Mungesa e fleksibilitetit Stimuj të dobët për iniciativën personale	"Lojtarët e vetos" mund të bllokojnë vendimet Rregullat janë të vështira për t'i zbatuar në qoftë se ata thyen
Kompensimi	Demokracia dhe të drejtat e njeriut Sundimi i ligjit Kontrollet dhe balancat në kushtetutë	Sanksione morale Kultura e përgjegjësisë

2. Çështja e pronës: kush është pronari i peshkut të kapur?

Dy opsione themelore dhe disa kritere për të menduar rreth:

	Prona private	Prona publike
Rregullat e pronësisë	Çdo peshkatar zotëron atë që kap Ai mund ta përdorë peshkun e kapur si të dojë	Çdo peshkatar e dorëzon peshkun e kapur në një përfaqësues publik Peshqit shpërndahen tek anëtarët e komunitetit
Stimulues për peshkatarët		
Efekti në prodhim total të peshkut		
Efekti në rezervat e peshkut		

3. Pyetje të tjera për të marrë parasysh kur projektojmë institucionet

- A doni të përcaktoni një objektivi që duhet të arrihet?
- Kush e ka fuqinë për të marrë vendime?
- A doni mjete për të siguruar zbatimin e rregullave?
- A ekziston rreziku i abuzimit me pushtetin?

Fleta e punës për nxënësit 5.3

Krahasimi i rregullave

Kriteret për krahasim	Drafti ynë	Modele të tjera		
		Nr. 1	Nr.2	Nr. 3
A. Rregullat bazë Hierarkia				
Rrjeti				
Prona private				
Prona publike				
Komentet				
B. Rregullat Qëllimet				
Fuqia e vendimit				
Zbatimi rregullave				
Shpërdorimi i pushtetit				
.....				
Komente				

Fleta e punës për nxënësit 5.4

Rregullat procedurale për konferencën - draft

Miratimi i rregullave procedurale

1. Komuniteti miraton një projekt rregullash procedurale nga një shumicë prej 50% ose më shumë të të gjitha votave të hedhura.
2. Në qoftë se nuk ka ndryshime të sugjeruara për këtë projekt, ai mund të miratohet nga një votë në bllok. Ndryshimet duhet të votohen veçmas.

Kryetari

3. Me shumicë votash, një anëtar i komunitetit emërohet si kryetar. Kryetari mund të marrë pjesë në votimit të projektligjeve të kornizës, por nuk mund të kryejnë rolin e zëdhënësit (rregulla nr. 5).

Deklarata përfundimtare e promovimit

4. Anëtarët e komunitetit tregojnë preferencën e tyre për një projekt model përmes votimit. Ata formojnë parti që mund të llobojë për modelin e tyre.
5. Një zëdhënës bën një deklaratë promovuese për partinë e tij, që zgjat jo më shumë se dy minuta.
6. Gjatë procedurës së votimit nuk lejohet debat i mëtejshëm.

Procedura e votimit

7. Votimi: anëtarët e komunitetit të miratojnë një projekt me votë. Të gjitha votat numërohen në mënyrë të barabartë. Anëtarët votojnë me shfaqjen e duarve.
8. Vendim me dy-faza: votimi i drafteve zhvillohet në dy raunde.

8.1 Raundi i parë: anëtarët e komunitetit votojnë për një nga drafetet.

8.2 Raundi i dytë: të dy drafetet me sasinë më të lartë të votave votohen në një kohë të dytë. Komuniteti miraton draftin që merr numrin më të lartë të votave.

8.3 Nëse të dy drafetet marrin numër të barabartë votash, organizohet një diskutim para se të përsëritet votimi.

Dokumentimi dhe autorizimi

9. Shkruesi i draftit shkruan datën dhe vendin e konferencës në fund të dokumentit rregullator.
10. Të gjithë anëtarët e komunitetit nënshkruajnë dokumentin.

Fleta e punës për nxënësit 5.5

Përmbledhje: çfarë mund të mësojmë përmes këtyre lojërave?

1 Zhvillimi i një komuniteti: Vijimësi problemesh dhe zgjidhjesh


PROBLEMI	ZGJIDHJE
Si mund të mbijetojmë?	Ne duhet të mbështetemi në burimet natyrore që kemi - peshk.
Si mund të zgjidhim konfliktin tonë nga mbipeshkimi?	1. Ne kemi nevojë për një koncept të qëndrueshmërisë. 2. Ne kemi nevojë për një kuadër rregullash për të organizuar proceset tona të komunikimit dhe vendimmarrjes.
1. Si mund të përcaktojmë qëndrueshmërinë?	Na nevojitet një ekuilibër mes disa qëllimeve. Në fakt, ne duhet të prodhojmë peshk aq sa rezervat mund të japin pa u varfëruar, në mënyrë që të sigurohet stabilitet për të ardhmen. Ne duhet të ndajmë prodhimin në mënyrë të drejtë.
2. Çfarë lloj rregullash na nevojiten?	Për hartimin e rregullave tona, ne duhet të zgjedhim ndërmjet disa parimeve të ndryshme: duke krijuar një shtet apo duke zhvilluar një rrjet të barabartësh.
Si mund të parandalojmë abuzimin e pushtetit?	Në duart një personi të vetëm nuk duhet të vendoset shumë pushtet. Kushtetutat zbatojnë mjetet e mëposhtme: kontrolli dhe balanca, sundimi i ligjit, duke u dhënë të drejtave të njeriut statusin e të drejtave civile, duke kufizuar periudhat në zyrë, referendumet, autonominë kantonale dhe federale, shtypin dhe medien të lirë.
Kush vendos se çfarë kuadri i rregullave të caktojmë?	Të gjithë së bashku. Ne hartojmë kornizat dhe pastaj bëjmë një zgjedhje e votojmë për të.
Si mund të organizojmë këtë proces në mënyrë të drejtë dhe efikase?	Ne kemi ngritur një axhendë. Na nevojitet një kornizë e veçantë e rregullave procedurale për të cilën ne biem dakord më parë.

2. Përfundime

1. Politika është një përpjekje për të menaxhuar problemet që ndikojnë në mirëqenien dhe mbijetesën e bashkësisë. Institucione të tilla si kornizat e rregullave janë mjete për të zgjidhur problemet. Nëse ata nuk i shërbejnë qëllimit të tyre, ato mund dhe duhet të ndryshohen.
2. Konflikti është gjithmonë pjesë e jetës shoqërore dhe politike. Edhe nëse konflikti nuk mund të çrrënjohet, është e mundur të kontrollohet potenciali i tij shkatëruar.
3. Loja e peshkimit dhe loja e vendimmarrjes veprojnë si modele. Ato vijnë mjaft afër realitetit historik kur përshkruajnë zhvillimin e një komuniteti si një seri problemesh dhe zgjidhjesh.
4. Realiteti ndryshon nga lojrat në dy aspekte të rëndësishme. Së pari, ne nuk kemi të dhëna të tilla të sakta për burimet tona natyrore, siç janë në dispozicion në lojë. Së dyti, demokracitë nuk kanë rrënjë demokratike. Demokracia dhe të drejtat e njeriut nuk janë krijuar me anë të konferencave, por përmes konfliktit.

Fleta e punës për nxënësit 6.1

Modeli ciklik i politikës: politika si një proces i zgjidhjes së problemeve në një komunitet



Fleta e punës për nxënësit 6.2

Cikli politik - një mjet për të vëzhguar dhe kuptuar proceset e vendim-marrjes politike


Konceptet dhe pyetje kyçe Përshtatini pyetjet si të jenë të nevojshme	Shenime	Burimet e informacionit
1. Çështja Cili është problemi?		
2. Problem Kush e përcakton rendin e ditës Cili është problemi? A pajtohen të gjithë protagonistët me përkufizimin e problemit?		
3. Debati Kush është i përfshirë? Cilat janë interesat dhe vlerat e protagonistëve?		
4. Vendimi Cili është rezultati? I është dhënë prioritet interesave të caktuara, apo është një vendim kompromisi?		
5. Zbatimi Si është zbatuar vendimi? Kush është i përfshirë apo përgjegjësi? A ka probleme apo konflikte?		
6. Opinione Cilët individë, protagonistë, grupe etj. e mbështetin apo e kritikojnë rezultatin? Cilat janë vlerat e tyre, ideologjitë dhe interesat?		
7. Reagimet Si reagojnë ata? (Individualisht, kolektivisht?) Cilat janë mjetet për të ushtruar pushtet dhe presion?		
8. Problem i ri, problem i vjetër apo një zgjidhje? A ka një debat të ri për përcaktimin e një axhende të re? Cili është problemi? I vjetër apo i ri? A ka çuar vendimi në zgjidhje që i jep fund procesit?		

Fleta e punës për nxënësit 6.3 Reagime nga njësia "Qeverisja dhe politika"

Klasa:

Data:

1. Tabelë qitje (5: Unë pajtohem plotësisht - 1: Unë nuk pajtohem fare)



2. Vlerësimi im personal

2.1 Gjëja më e rëndësishme dhe interesante që kam mësuar:

2.2 Ajo që nuk mu duk interesante apo e dobishme:

Fleta e punës për nxënësit 7.1


A është sundimi i shumicës ndaj pakicës i padrejtë? Një studim rasti

Një klub sportiv ka një numër të madh lojtarësh volejboli të mirë dhe një numër më të vogël lojtarësh që kanë prirje në lojën e shahut. Të dy grupet marrin pjesë në garat e kampionatit dhe kanë pasur sukses në tërheqjen e anëtarëve të rinj. Çdo anëtar paguan të njëjtin kontribut vjetor për klubin. Një herë në vit, mbahet një takim, në të cilin, të gjithë anëtarët vendosin me shumicë votash se si të shpenzojnë paratë. Lojtarët e volejbollit kanë një listë të gjatë kërkesash, duke përfshirë furnizimin e rregullt me topa të rinj, veshje të reja për ekipin e tyre dhe përmirësimin e fushës së volejbollit. Lojtarët e shahut kanë nevojë për materiale trajnimi për fillestarët, për libra dhe revista, si dhe për një dhomë më të madhe, me më shumë tabela shahu, më shumë tavolina dhe karrige për arsye të numrit në rritje të anëtarëve.

Folësit e lojtarëve të volejbollit dhe të shahut paraqesin rastet e tyre. Në vjim, merret një vendim me shumicë votash. Çdo vit, grupi i vogël i shahut mundet nga mbivotimi i lojtarëve të shumtë të volejbollit. Të gjitha paratë shkojnë në projektet e volejbollit dhe lojtarët e shahut duhet ta shtynë me atë që kanë.

Lojtarët e shahut janë të zhgënjyer dhe kanë humbur durimin. Në fund të fundit, kontributet e tyre po shpenzohen për projektet e volejbollit. Ata ndjehen si anëtarë të shpërfillur dhe disa prej tyre janë shprehur për ndarjen në dy klube të veçanta.

Shumica e lojtarëve të volejbollit tunden kokat e tyre. Rregullat e shumicës - kjo është demokracia. Dhe në qoftë se ju mundeni nga mbivotimi - kjo është pjesë e lojës. Por, disa nga lojtarët e volejbollit e ndjejnë se kjo pikëpamje është pak si tepër e thjeshtë. Lojë e ndershme do të thotë se edhe interesat e lojtarëve të shahut duhet të meren parasysh. Por si?



Struktura e anëtarësimit në klubin sportiv - një shembull i thjeshtë i pluralizmit. Shoqëritë pluraliste kanë të njëjtën lloj strukture, por sigurisht më komplekse. Grupe të ndryshme kanë interesa të ndryshme që mund të konkurrojnë me njëri-tjetrin. Sa më komplekse të jetë një shoqëri, aq më shumë mundësi ka për konflikt të interesave. Demokracia dhe të drejtat e njeriut japin mjete për të zgjidhur këto konflikte në mënyrë të drejtë, domethënë në mënyrë paqësore.

Studim Rasti përshtatur nga: David Miller, *Filozofia politike. Një hyrje e shkurtër*. Oxford, 2003, f. 5.

Fleta e punës për nxënësit 7.2

Si kujdesen demokracitë për mbrojtjen e pakicave?

Problemi si të balancohen të drejtat e shumicës dhe të pakicave është një çështje thelbësore në të gjitha nivelet e komunitetit, nga klubet e vogla deri në nivelin shtetëror. Nga njëra anë, vullneti i shumicës në një demokraci duhet të respektohet. Nga ana tjetër, duhet të respektohen edhe interesat e pakicave. Nëse ekziston një grup humbësish të përherëshëm, që mendojnë se po diskriminohen, kjo mund të çojë në konflikt serioz brenda një komuniteti.

Zakonisht, në kushtetutat e demokracive, zbatohen dy zgjidhje - të dyja vendosin kufijtë për atë që mund të vendosë shumica. Njëra synon të kufizojë pushtetin e shumicës, duke i dhënë entiteve më të vogla të drejta të autonomisë (modeli federal ose kantonal). Zgjidhja tjetër synon të përfshijë të drejtat e njeriut si të drejta civile. Këto të drejta mbrojnë individët dhe grupet e pakicave, sepse shumica duhet t'i respektojë këto të drejta.

1. Modeli federal/kantonal

Grupet e pakicave formojnë subjekte rajonale brenda shtetit - shtete federale ose kantone. SHBA, Gjermania dhe Belgjika janë shembuj të federalizmit, ndërsa Zvicra është një shembull i modelit kantonal. Në kuadër të këtyre subjekteve të vogla, shumica vendos, dhe kjo mund të përfshijë të drejtën për të kontrolluar buxhetin e dikujt ose të pjesëmarrjes në legjislacionin kombëtar. Kushtetutat demokratike ndryshojnë në sasinë e autonomisë që u japin nën-subjekteve.

Kjo ide mund të çohet edhe më tej, duke ndryshuar përkufizimin e shumicës. Nëse vendimet e caktuara kërkojnë detyrimisht praninë e një numri të caktuar për të votuar prej më shumë se 50-75% ose edhe 100% , grupet e pakicave mund të ndikojnë në vendimet politike dhe mund të kenë edhe të drejtën e vetos.

2. Të drejtat e njeriut si të drejtat e pakicave

Të drejtat e njeriut funksionojnë si të drejta të pakicave, duke vendosur kufizime në atë që shumica mund të vendosë. Shqyrtoni , për shembull, këto nene **nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e 4 nëntorit 1950:**

Neni 5, E drejta për liri dhe ...

Çdokush ka të drejtën e lirisë e...

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Nenet 5 dhe 14 bazohen në dy parime të drejtave të njeriut - liria dhe barazia.

Qytetarët, të drejtat e njeriut e të cilëve janë shkelur në një shtet anëtar të Këshillit të Europës, mund të ankohen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Të drejtat e njeriut bëhen të drejta civile sapo të bëhen pjesë e kushtetutës. Në këtë rast, ata janë të mbrojtura më fuqishëm, pasi tani janë pjesë e sistemit juridik, por zbatohen vetëm për qytetarët e atij shteti. Në disa vende, është krijuar gjykata kushtetuese për të mbrojtur të drejtat civile. Ndryshimet e kushtetutës zakonisht kërkojnë më shumë se një shumicë të thjeshtë, kështu që grupet minoritare mund të parandalojnë ndryshimet që punojnë në dëm të tyre.

Fleta e punës për nxënësit 7.3

Detyra: hartimi i një statuti për klubin sportiv

1. Hartimi i rregullave (neni 1, neni 2, neni 3, etj ...) që zgjidhin pyetjet e mëposhtme:
 - Si duhet të shpërndahen fondet midis grupeve?
 - Kush vendos për shpërndarjen e fondeve?
 - A duhet t'u jepen grupeve të drejtat e autonomisë?
 - Si duhet të zbatohet parimi i mosdiskriminimit, me qëllim që të mbrohet drejtat dhe interesat e shumicës dhe pakicës?
 - ... *(Në qoftë se ju dëshironi, përfshini pyetje të tjera që mendoni se janë të rëndësishme).*
2. Përgatitni një prezantim të statudit që trajton këto pyetje. Nëse është e nevojshme, shkruani rregullat tuaja në një fletë A4, që mund ta bashkëngjitni te matrica.
3. Këto pyetje do të shërbejnë si një listë e plotë për të krahasuar rezultatet tuaja me ato të grupeve të tjera (shih dhe Fletën e punës së nxënësit 7.4).

Fleta e punës për nxënësit 7.4

Regjistri i prezantimeve të grupit: projekt statutet për një mikro-komunitet

Regjistroni rezultatet e grupit në formular dhe përfshini idetë e grupeve të tjera në seancën e prezantimit.

Çështjet kyç	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5	Krahasim
Shpërndarja e fondeve						
Kush vendos për shpërndarjen?						
Autonomia për grupet						
Parimi i mosdiskriminimit (shumicë / pakicë)						
...						

Gjykimi i projektstatutit - pyetje kyçe

1. *Drejtësia*: A e zgjidh ky statut problemin shumicë/pakicë në mënyrë të drejtë?
2. *Demokracia*: A e respekton ky statut parimin e sundimit të shumicës?
3. *Efikasiteti*: A do veprojnë rregullat për marrjen e vendimeve pa probleme?
4. *Balancimi dhe/ose përcaktimi i prioriteteve*: A ka gjetur statuti një kompromis mes interesave dhe parimeve të ndryshme, apo i ka dhënë prioritet njërit ndaj tjetrit?
5. ...

Si t'i përdorni këto pyetje

Mundohuni t'i përgjigjeni çdo pyetjeje me radhë. Në qoftë se dëshironi, përfshini edhe pyetje të tjera.

Në qoftë se ju vendosni të lini jashtë një pyetje dhe të përqëndrohni te të tjerat, jepni arsyt tuaja për këtë zgjedhje.

Shkruani gjykimin tuaj, me arsye.

Arsyet për këto udhëzime

Ju jeni të lirë të formoni mendimin tuaj. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë të drejtat e njeriut.

Që këtë rrjedh se, nuk ka mendim të "gabuar" apo "të drejtë".

Për të ndihmuar njëri-tjetrin në kuptimin e ideve, duhet t'i argumentojmë ato. Por edhe këtu, ka dallime në cilësi. Disa argumente janë më bindëse, të menduara më me kujdes se të tjerët.

Kur marrim pjesë në demokraci, të menduarit e kujdesshëm dhe aftësitë e mira të argumentimit janë të rëndësishme për të fituar mbështetjen e njerëzve të tjerë për qëllimet tona. Kjo është arsyeja pse ju duhet t'i zhvilloni ato nëpërmjet kësaj detyre.

Fleta e punës për nxënësit 8.1

Sugjerime për një çështje të debatuar

Detyra juaj

1. Së pari, mblidhni të gjitha idetë që ju vijnë në mendje dhe shënojin ato.
2. Gruponi idetë tuaja sipas kategorive.
3. Pastaj, i krahasoni ato me kriteret e mëposhtme:
 - a. A kërkojnë ato një zgjedhje për t'u bërë apo një vendim për t'u marrë?
 - b. A ka arsye të mira për të argumentuar pro dhe kundër një zgjedhjeje ose vendimi të caktuar?
 - c. A keni ju dhe nxënësit e tjerë të klasës njohuri në lidhje me këtë çështje?
 - d. A mendoni ju se kjo çështje do t'u interesojë nxënësve në klasën tuaj?
 - e. A keni ju dhe nxënësit e tjerë informacionin e nevojshëm dhe, a mund ta siguronin atë? (Ndoshta ju dini shumë nga përvoja e përditshme ose mund të mblidhni të dhëna ose raporte nga burime të tjera, të tilla si: libra, gazet, internet.)

Nëse ju i përgjigjeni pyetjeve nga **a - e** me Jo, sugjerimi juaj nuk vlen

4. Zgjidhni një ose dy ide dhe, nëse është e nevojshme, mblidhni materiale për to. Ju mund ta shprehni çështjen në formën e një teze ose me një pyetje po/jo.
5. Shkruani sugjerimin tuaj në tabelë sipas kategorisë që i takon, së bashku me emrat tuaj. Sigurohuni që të dorëzoni rezultatet tuaja para mbarimit të afatit, në mënyrë që të gjithë të mund të lexojnë kontributin tuaj.
6. Priteni fletën e shënimeve poshtë, plotësojeni dhe vendoseni ku t'ju thotë mësuesi juaj. Shtoni materialet tuaja.
7. Lexoni tabelën dhe materialet e nxënësve të tjerë para mësimit.

✂ _____

Fletë Shënimesh: Sugjerime për një çështje debati		
Emrat: _____		


Çështja	Kategoria (jeta e përditshme, jeta shkollore etj)	Materialet

Fleta e punës për nxënësit 8.2

Rregullat për debat

Rregullat e uljes

Kryetari ulet në krye të tavolinës. Të dy palët debatuese janë ulur përballë njëri-tjetrit. Audiencia rri një distancë të afërt nga tabela dhe duhet të jetë në gjendje të shohë të dyja palët. Pra, nëse janë të nevojshme vende shtesë për audiencën, ato duhet të organizohen në disa rreshta, por jo prapa palëve në debat.



Renditja e folësve

Shigjetat tregojnë rendin e folësve në raundin e parë të debatit. Në raundin e dytë, rendi i folësve është thjesht i kundërt, derisa të flasë folësi i parë për anën pohuese.. Pastaj, një drejtues për anën mohuese ka fjalën e fundit; ekipi mund të zgjedhë një anëtar për të dhënë këtë deklaratë, por jo nga folësi i parë, pasi kjo do t'i japë atij dy minuta kohë më shumë për të folur dhe kjo do të ishte e padrejtë për palën tjetër.

Rregullat për debat

1. Folësi i parë për anën pohuese, i ulur pranë kryetarit, merr fjalën. Pastaj, siç tregohet nga shigjetat në diagram, folësi i parë për anën mohuese përgjigjet. Në këtë mënyrë, folësit për të dyja palët, marrin

fjalën me radhë. Pasi flet folësi i fundit për anën negative, fillon raundi i dytë i debatit, këtë herë në kah të kundërt.

2. Pas ka folur folësi i parë për anën pozitive, një folës nga ekipi negativ (por jo kryetar i tyre i parë) ka fjalën e fundit.

3. Radha e folësve nuk duhet të ndryshohet.

4. Çdo folës ka një kohë maksimale prej një minute. Kryetari kontrollon kohën me kujdes. Ai jep shenjë, kur folësi ka 10 sekonda për të folur dhe, pas përfundimit të kohës, folësi duhet të ndalë. Koha e tepërt nuk mund t'i transferohet një tjetër folësi.

5. Ndërprerja e një folësi është e ndaluar.

6. Publiku nuk duhet të marrë pjesë në debat.

7. Pas debatit, audienca ka pesë minuta për të ndarë përshtypjet dhe mendimet. Pastaj, ata votojnë me ngritjen e duarve.

8. Në votim, numërohen votat Po dhe Jo. Shumica fiton votimin.

Këshilla për folësit e debatit

1. Me përjashtim të kryetarit të parë për anën pozitive, shpenzoni afërsisht gjysmën e parë të deklaratës suaj për të hedhur poshtë argumentin e anës tjetër dhe pastaj paraqisni një pikë të re.

2. (Për folësit e parë.) Shpallni lëvizjen tuaj - thoni vendimin që dëshironi të shihni.

3. Kur të përgatiteni për debat, në fillim skanoni idetë. Pastaj vendosni në cilën mënyrë doni të paraqitni pikët tuaja dhe caktojani ato një folësi. Filloni dhe përfundoni me një pikë të fortë dhe mbresëlënëse (shih Fletën e punës së nxënësit 8.2).

4. Ju mund të përsëritni ose të ndryshoni një argument kyç për t'u "stërvitur në shtëpi".

5. Folësit e fundit duhet përmbledhin argumentet e palës së tyre, duke theksuar tre ose katër pika. Çfarë duhet t'i mbetet në mend audiencës pas debatit? Nëse debati është rreth një vendimi që do të merret, bëjeni të qartë se cila është këkesa juaj për audiencën kur ata të votojnë pas debatit.

6. Flisni lirisht. Mos e lexoni deklaratën nga shënimet, por vendosni kontaktin me sy me kundërshtarët dhe me audiencën tuaj.

7. Trajtoni kundërshtarët me respekt. Asnjëherë mos fyeni një drejtues, por punoni për argumentet e tij.

Këshilla për audiencën (shih Fletën e punës së nxënësit 8.5)

1. Para debatit, përpiquni të parashikoni argumentet e të dy palëve, çfarë munden apo duhet të paraqesin. Kjo ju jep një kuadër referimi kur dëgjoni debatin.

2. Merrni shënime për argumentet e paraqitura nga të dyja anët, nëse është e mundur, në një fjali.

3. Lidhni argumentet me të kundërtat me vija ose shigjeta dhe bëni ndonjë koment. Cili argument ju bindi? (Hapat 2 dhe 3 mund të ndahet në mes të disa dëgjuesve.)

4. Shënioni cilat argumente ju bënë përshtypje të veantë

5. Pas debatit, ndani rezultatet tuaja në grup. Votoni për propozimet e paraqitura nga dy palët.

Fleta e punës për nxënësit 8.3

Fletë planifikimi për ekipet e debatit

Emri i folësit	Argumenti	Shënime
Ju lutem mbani rendin e treguar në diagramin në fletën e punës për nxënësit 8.2		
1	<i>Rekomandimi: përcakto lëvizjen t'ënde</i>	
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10*	<i>Fjala e fundit (përmbledhje e pikave kryesore)</i>	

* Fjala e fundit – folësit

Folësi i parë për anën pohuese ka fjalën e fundit (shih diagramën në fletën e punës së nxënësit 8.2) Pastaj vijon folësi i palës negative. Skuadra zgjedh një anëtar ta bëjë këtë, por jo folësin e parë, sepse atij i bie të flasë për dy minuta, gjë që është e padrejtë për palën tjetër.

Fleta e punës për nxënësit 8.4

Fletë planifikimi për kryetarët

Detyra e kryetarit të parë - kryeson debatin

Kryetari drejton debatin dhe sigurohet që debatuesit të respektojnë rregullat e debatit (shih & Fletën e punës së nxënësit 8.2) dhe të trajtojnë njëri-tjetrin në mënyrë të drejtë dhe me respekt. Kryesuesi është neutral dhe nuk priret drejt ndonjërit prej ekipeve në debat.

Në veçanti, kryetari është kontrollues i kohës. Asnjë folës nuk duhet të flasë më shumë se një minutë. Në praktikë kjo do të thotë se pasi minuta ka mbaruar, folësi duhet të përfundojë fjalinë e tij të fundit dhe më pas të ndalet. Nëse është e nevojshme, kryetari me mirësjellje, por në mënyrë të vendosur, e ndërpret folësin dhe i jep fjalën kryetarit të ekipit tjetër.

Pajisje

- Një kronometër ose orë që tregon saktësisht sekondat. Telefonat celularë mund ta kryejnë një funksion të tillë.
- Fletë shënimi dhe lapës.
- Një letër të verdhë dhe një të kuqe letre ose karton, madhësia A7.
- Shtesa & Fletët e punës së nxënësit 8.2, 8.5.

Detyra e kryetarit gjatë debatit

1. Ai hap debatin:

- Përshëndet ekipet, audiencën si dhe gazetarët e lajmeve.
- Përmbledhje e shkurtër e debatit, pa ndonjë hollësi që mund të ndihmojnë një anë.
- Kujtesë për ekipet: lojë e ndershme, zbatim i rregullave.
- Shpallja e rregullave të kohë-matjes: pas 50 sekondave, kryetari jep një shenjë.
- Pas një minutë, kryetari ndalon folësin - për të siguruar lojë të ndershme.

2. Gjatë debatit:

- Kryetari dëgjon debatin në heshtje.
- Kryetari monitoron kohën e të folurit dhe i jep shenjë 50-të sekondëshe.
(Shumë shpesh, kjo është gjithëshka që bën kryetari.)
- Kryetari ndërhyt nëse folësit kalon për kohën e tyre duke folur për një minutë.
- Kryetari ndërhyt nëse debatuesit ose audienca ndërpresin folësin në ndonjë mënyrë.
- Në raste shumë të rënda të sjelljes së keqe ose të padrejtë, kryesuesi tregon kartonin e verdhë ose /dhe të kuqin ndaj një folësi. Kartoni i kuq do të thotë se një folësi duhet të lërë debatin.

3. Pas debatit:

- Kryetari njofton se debati është mbyllur.
- Kryetari falënderon debatuesit dhe publikun.

Roli i kryetarit, pas debatit

Pas debatit, publiku ka një diskutim të shkurtër vijues për debatin (pesë minuta) dhe pastaj voton për anën që, sipas tij, paraqiti argumentet më bindëse.

Detyra e dytë e kryetarit – kryesimi i votimit të publikut dhe diskutime

1. Vijim diskutimi

- Kryetari njofton se publiku ka pesë minuta gjatë të cilave mund të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre për debatin. Vendet janë të riorganizuara në një rreth ose gjysmërreth të madh, për të lejuar të gjithë nxënësit që të përballen me njëri-tjetrin.
- Çdo anëtar i audiencës ka bërë shënime gjatë debatit dhe ka menduar në lidhje me pyetjen se cili grup ka debatuar më bindshëm. Kryetari kërkon një votim me duar - një votim paraprak.
- Pastaj marrin fjalën nxënësit që kanë pikëpamje të ndryshme. Kryetari u kërkon atyre të shkëmbejnë mendimet në të njëjtën mënyrë si bënë debatuesit, sepse koha është e pakët.
- Pas pesë minutave kryetari përfundon diskutimin.

2. Votimi

- Kryetari shpall votimin. Ai e përsërit çështjen dhe pyetjet që duhet të votohen: cili ekip ju ka bindur më shumë - pohuesi apo mohuesi? Në këtë pikë nuk ka më diskutime. Kryetari i kërkon një nxënësi të shënojë rezultatet e votimit në dërrasë apo tabelë.
- Kryetari, së pari, u kërkon nxënësve, që janë më të bindur për anën pohuese, të ngrenë duart. Ai i numëron ato dhe pastaj, në të njëjtën mënyrë, kryen votimin për anën pohuese.
- Së fundi, nxënësit që abstenojnë - të cilët nuk kanë votuar për asnjë nga ekipet - thirren dhe numërohen.
- Kryetari lexon rezultatin e votimit, por nuk komenton për të. Ai falënderon audiencën për diskutimet dhe votën e tyre dhe përfundon seancën.

Fleta e punës për nxënësit 8.6

Tabela për shkrimtarët e lajmeve

Detyra

Formoni tri ekipe zinxhir.

Shkruani një histori lajmi për debatin dhe paraqiteni artikullin tuaj në mësimin e ardhshëm. Vareni atë në mur, nëse është e mundur në dy ose tri kopje.

Çdo ekip punon për një lloj të ndryshëm gazete/periodiku:

- gazetë tabloidi;
- gazetë cilësore;
- revistë për të rinj.

Profili i tri gazetave - çka presin lexuesit

Ka disa rregulla të përgjithshme për të shkruar një histori të mirë lajmesh - shih Fletën e punës së nxënësit 9.1.

Por, nga ana tjetër, çdo gazetë raporton për një audiencë të ndryshme, kështu që historia juaj e lajmeve duhet t'i drejtohet këtij grupi, në qoftë se dëshironi që lexuesit të blejnë gazetën që ju jep punën tuaj. Kjo do të thotë se, tregimet tuaja të lajmeve do të jenë mjaft të ndryshme, edhe pse po raportoni për të njëjtin debat. Shikoni si bëhet kjo në një gazetë të vërtetë.

Lloji i gazetës	Çfarë presin lexuesit				
	*** prioritet i lartë / ** e rëndësishme / * e bukur për ta pasur				
	Argëtim	Piktura	Informacion (çështje dhe argumente)	Këndvështrim i të rinjve	"prekje personale"
Gazetë tabloid	**	**	**	*	***
Gazetë cilësore	*	**	***	*	*
Revista të rinjsh	**	**	**	***	*

Fleta e punës për nxënësit 9.1

Krijimi i një gazete muri – Çfarë të zgjedhim

Udhëzimet për detyrën

Ju do të prodhoni vetë gazetën tuaj të murit. Përgatiteni këtë punë duke menduar për idetë tuaja. Çfarë tregimesh, artikujsh dhe fotosh do sugjeronit? Jepni arsyet tuaja, pasi kjo do t'ju ndihmojë kur të diskutoni zgjedhjet tuaja përfundimtare.

	Sugjerimet tuaja	Arsyet tuaja
Pikët për t'u marrë parasysh (kriteret)	1. Histori kryesore?	
1. Vlera e lajmit Cila është rëndësia e tregimit? A përmban historia informacion të rëndësishëm që lexuesit juaj duhet të dinë rreth saj?	2. Tregime të tjera?	
2. Histori kryesore Historia kryesore duhet të jetë diçka tërheqëse për të tërhequr lexuesit e mundshëm. A mund ta mbështesni historinë kryesore me një foto?	3. Udhëheqësi (koment) - në çfarë historie?	
3. Fotografitë Konsideroni një foto me një nëntekst në vend të një historie.	4. Fotografi - në çfarë tregimi?	
4. Bilanci i përmbajtjes Shembuj: Të njohura / të panjohura Pozitive / negative Lajme të fundit/ "interes njerëzor" Historitë e suksesit / histori konflikti	5. Tregime dhe tema të një rëndësie më të vogël - çfarë mund të hiqet?	

Bazuar te: Qendra për Edukim Mediatik (2005), Pesë pyetje kryesore që mund të ndryshojnë botën, Mësim 1c, fq. 21 (përshtatur); www.medialit.org.

Fleta e punës për nxënësit 9.2

Këshilla për prodhimin e një gazete muri

Caktoni detyrat e mëposhtme për anëtarët e ekipeve të ndryshme (shih shënimet informative më poshtë):

- Një kryeredaktor të kryesojë takimin tuaj;
- Një menaxher kohe për të mbikëqyrë prodhimin e gazetës;
- Një prezantues për të shpjeguar vendimet tuaja në seancën plenare vijuese.

Projekti i orarit

1. Miratoni ose ndryshoni këtë draft orar.
2. Diskutoni dhe vendosin se çfarë temash do të zgjidhni - dhe do të hiqni (Fleta e punës së nxënësit 9.1).
3. Caktoni detyrat e kërkimit dhe / ose shkrimit për secilin anëtar të ekipit. Bini dakord për një orar për punën tuaj.
4. Bëjeni punën për tregimet tuaja të lajmeve - kërkimore, shkrime, mbledhje materiali dhe fotografi.
5. Faqosni gazetën tuaj të murit.
6. Shfaqeni gazetën tuaj në klasë.

Shënime informuese

Kryeredaktori

Ju drejtoni diskutimet dhe vendimmarrjen në ekipin tuaj.
Sigurohuni që të gjithë të kenë mundësi për të ndarë idetë dhe mendimet e tyre me ekipin.
Ndërhyni kur e shihni që dikush nuk është duke ju dëgjuar.
Sugjeroni çfarë historie duhet të përfshihet në gazetën tuaj.
Sigurohuni që ekipi punon me efikasitet. Sugjeroni një orar pune realist, duke lejuar kohë të mjaftueshme për punën bazë – mbledhja e informacionit dhe të shkruarit.

Menaxheri kohës

Ju mbikëqyrni orarin e prodhimit të gazetës.
Nëse ju zbuloni se ekipi është vonë dhe do të kenë probleme me përfundimin, bisedoni me anëtarët e ekipit dhe informoni kryeredaktorin.
Sugjeroni çfarë mund të bëjë ekipi për të përfunduar në kohë.

Prezantuesja

Në mësimin që vijon, bëni një prezantim të shkurtër për t'u shpjeguar ekipeve të tjera:

- Arsyet pse ju zgjodhët një temë të caktuar si histori kryesore;
- Çfarë temash të tjera i konsideroni të rëndësishme për t'u përfshirë dhe pse, më në fund, e zgjodhët apo e hoqët njërin prej tyre;
- Pse i keni zgjedhur fotografitë;
- Ndonjë çështje tjetër për të cilën diskutoi ekipi juaj.

Fleta e punës për nxënësit 9.3

Këshilla për të shkruar një histori të mirë lajmi

Para se të filloni të shkruani

Mendoni për qëllimin e tregimit tuaj: për një histori lajmesh që ka të ngjarë do të shërbejë për të informuar publikun.

Bëni disa kërkime dhe zhvilloni intervista, duke mbajtur shënime dhe duke shkruar citate të dobishme.

Ndërkohë që shkruani

Përdorni folje aktive, për të treguar se çfarë po ndodh në të vërtetë.

Në fillim tregoni informacionin më të vërtetë interesant

Ndiqni skicën më poshtë.

Paragrafi i parë

Mundohuni të peshkoni lexuesin duke filluar me një deklaratë të këndshme, të mençur apo të habitshme. Përpiquni për shumëllojshmëri - përpiquni të filloni artikullin me një pyetje ose një deklaratë provokative. Në fjalinë tuaj të parë ose të dytë përdorni pyetjet kush, çfarë, kur, ku dhe pse.

Paragrafi i dytë / i tretë / i katërt

Jepini lexuesit detajet duke i shtrirë në pesë pyetjet e mëposhtme:

- Kush ishte i përfshirë?
- Çfarë ka ndodhur?
- Ku ndodhi?
- Kur ndodhi?
- Pse ndodhi kjo?

Përfshini një ose dy citate nga njerëz të intervistuar. Shkruani në vetën e tretë (ai, ajo ose ata).

Mos harroni të qëndroni objektiv dhe kurrë mos e shprehni hapur mendimin tuaj. Përdorni citate për të shprehur mendimet e të tjerëve.

Paragrafi i fundit

Përfundojeni atë dhe mos e mbani lexuesin në pritje. Provoni t'i jepni fund me një thënie ose një frazë që të mbetet në mendje ose bëni një përmbledhje të pastër.

(shkurtim)

Burimi: Media Rrjeti Ndërgjegjësimi

Dokumenti origjinal: Planifikimi mësimi, Reporter për një ditë

Author: Ginie Waller

www.media-awareness.ca

Ky është një manual për mësuesit e Edukimit për Qytetari Demokratike (EQD) dhe të Edukimit për të Drejtat e Njeriut (EDNJ), për redaktorët e teksteve dhe hartuesit e kurrikulës së EQD/EDNJ. Nëntë kapituj, me afërsisht, nga katër mësime secili, përqendrohen në konceptet themelore të EQD/EDNJ. Planifikimi i veprimtarive mësimeve përmban udhëzime hap pas hapi, fletë pune pune për nxënësit dhe informacion ndihmës për mësuesit. Në këtë mënyrë, manuali shërben, si për ata që janë të rinj në profesionin e mësuesit, ashtu edhe për mësuesit në punë që trajnohen në fushën e EQD/EDNJ. Edhe mësuesit me përvojë mund të mbështeten në idetë dhe materialet e këtij manuali. Manuali, në tërësi, ofron një kurrikul të plotë për klasat e arsimit të mesëm të ulët, por, meqë çdo kapitull i tij është i plotë në vetvete, ai lejon mundësi të mëdha përshtatjeje në përdorimin e tij.

Objektivi i EQD/EDNJ është qytetari aktiv, i gatshëm dhe i aftë të marrë pjesë në komunitetin demokratik. Për këtë arsye, EQD/EDNJ thekson me forcë veprimin dhe të mësuarit në bazë detyre. Komuniteti i shkollës trajtohet si një fushë e veçantë përvojë, ku të rinjtë mund të mësojnë si të marrin pjesë në vendimmarrjen demokratike dhe të ndër marrin përgjegjësi që në moshë të vogël. Konceptet themelore të EQD/EDNJ mësohen si instrumente të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Ky është Vëllimi IV nga një seri prej gjashtë:

EQD / EDNJ Vëllimi I:	<i>Edukimi për demokraci</i> - Materiale në ndihmë të mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut
EQD / EDNJ Vëllimi II	<i>Rritimi në demokraci</i> - Njësi mësimore për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut në arsimin fillor
EQD / EDNJ Vëllimi III	<i>Të jetojmë në demokraci</i> - Veprimtari mësimore për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut për arsimin e mesëm të ulët
EQD / EDNJ Vëllimi IV	<i>Pjesëmarrja në demokraci: Veprimtari mësimore për Qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut, për shkollën e mesme</i>
EQD / EDNJ Vëllimi V	<i>Të eksplorojmë të drejtat e njeriut</i> – Nëntë projekte të shkurtëra për arsimin fillor
EQD / EDNJ Vëllimi VI	<i>Mësimdhënia e demokracisë</i> – Një përmbledhje modelesh për qytetarinë demokratike dhe për të drejtat e njeriut.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

www.coe.int

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke mbuluar pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. Ajo kërkon të zhvillojë parime të përbashkëta demokratike dhe ligjore në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe tekste të tjera të referencës për mbrojtjen e individëve. Që kur ai u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli i Evropës ka simbolizuar pajtimin.

<http://book.coe.int>
Këshillit të Evropës